



UNITED NATIONS
KOSOVO TEAM



Raporti për Rezultatet 2022

Korniza e Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021–2025



Parathënie	1
Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë	2
Partnerët kyçë zhvillimorë të OKB-së në Kosovë	2
KAPITULLI 1: Zhvillimet kyçe në Kosovë dhe konteksti rajonal	4
KAPITULLI 2: Mbështetja e sistemit zhvillimor të OKB-së për prioritetet zhvillimore të Kosovës	6
Fusha prioritare 1: Qeverisja Llogaridhënëse	8
Fusha prioritare 2: Politikat dhe Shërbimet Sociale	9
Fusha prioritare 3: Rritja e Qëndrueshme Ekonomike	10
Fusha prioritare 4: Kohezioni Social	11
Fushat prioritare 5: Gjinia, fuqizimi dhe të dhënat	12
Mbështetja e partneriteteve dhe financimi për Agjendën 2030	13
Rezultatet e punës së përbashkët të OKB-së: Koherenca, Efektshmëria dhe Efikasiteti i OKB-së	14
Pasqyra financiare dhe mobilizimi i resurseve	15
KAPITULLI 3: Fokusi kyç i UNKT-së për vitin 2023	17
ANEKS: Përcjellja e progresit të Kornizës së Bashkëpunimit	19



Arnhild Spence
Koordinatorë për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara

“Që OKB-ja t’u ndihmojë qeverive të ecin përpara me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duhet të kemi trajtim më të mirë të të dhënave zhvillimore. Investimet tona në zhvillim duhet të vendosin qytetarët në qendër dhe së pari të targetojnë ata që janë më larg.”

Të nderuar lexues,

Në emër të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë¹ (UNKT), kam kënaqësinë t’ju prezantoj këtë Raport për Rezultatet për vitin 2022. Raporti ofron një pasqyrë të progresit të arritur në vitin 2022 nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, së bashku me partnerë të shumtë, në mbështetje të Kosovës për të arritur prioritetet e veta zhvillimore dhe qëllimet e përcaktuara në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Në vitin 2022, Kosova u përball me sfida të shumta, por tregoi reziliencë mbresëlënëse. Ekonomia e Kosovës, e cila kishte përjetuar një rimëkëmbje të fortë në vitin 2021, u përball me kërcënime nga rritja e inflacionit, mungesa e energjisë dhe ngadalësimi i rritjes së BPV-së. Qeveria zbatoi masat e reagimit dhe UNKT siguroi këshilla të vlefshme për targetimin e popullatave të cënueshme. Mbështetja jonë u shtri në zhvillimin e legjislacionit dhe politikave, duke përfshirë mbështetjen e miratimit të ligjeve kyçe që përbëjnë pjesë të agjendës së reformave evropiane të Kosovës dhe kontribuuan në përmirësimin e rezultatit të Kosovës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Reformat ligjore të propozuara, të cilat synojnë dënime më të rrepta për kryesit e dhunës në baza gjinore, forcimin e gatishmërisë për emergjenca mjekësore, dhe përmirësimin e qasjes në arsim, u dorëzuan në Kuvend. Ne gjithashtu lehtësuam funksionalizimin e Këshillit për Ndryshime Klimatike, duke rritur koordinimin dhe angazhimin e qeverisë ndaj Agjendës së Gjellbër të BE-së dhe përparimin e përgjithshëm drejt përafrimit të legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së.

Veç kësaj, UNKT luajti rol kyç në përgatitjen e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare, një hap vendimtar drejt adresimit të hendeqeve të të dhënave zhvillimore dhe përfundimisht krijimit të një platforme të OZHQ-ve për Kosovën. Këshillat tona teknike kontribuuan në vendosjen e një kornize rregullatore për buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore në institucionet qeveritare, duke promovuar ndarjen e barabartë të shpenzimeve publike dhe duke reduktuar pabarazitë gjinore.

UNKT vazhdoi të mbështesë nisma të rëndësishme, si forumi i nivelit të lartë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe fushatën 16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore. Angazhimi ynë me shoqërinë civile fuqizoi organizata vendore për të ofruar monitorim të pavarur dhe analizë të çështjeve të të drejtave të njeriut, si dhe rekomandime të targetuara.

Ne mbajtëm zotimin tonë për të ndihmuar grupet e cënueshme, duke siguruar qasje në shërbimet bazë. Përpjekjet tona lehtësuam gjithashtu kushte të sigurta për ata që dëshirojnë të kthehen. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve i finalizuar rishtazi, e zhvilluar me mbështetjen e UNKT-së, do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për të kthyerit. Për më tepër, OKB promovoi në mënyrë aktive të drejtat gjuhësore. Krijimi i Qendrës së Gjuhëve dhe programit të Ballkanistikës, si dhe rivendosja e Komisionit për Verifikimin e Diplomave, ishin hapa kritikë drejt sigurimit të qasjes së barabartë në arsim dhe punësim për komunitetet jo-shumicë. UNKT vazhdoi të mbështesë kapacitete për reagim dhe parandalim të Kosovës ndaj COVID-19.

Të gjitha sa më lart, dhe më shumë, pasqyrohen në këtë raport. Në bashkëpunim me qeverinë, jemi krenarë për arritjet tona. Ju ftojme të na bashkoheni në krenimin e këtyre arritjeve duke vlerësuar punën e vazhdueshme që kërkohet për të përmirësuar jetën e popullit të Kosovës.

¹ Të gjitha referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

UNKT përbëhet nga 14 agjenci rezidente dhe tri jo-rezidente të Kombeve të Bashkuara, fonde dhe programe, dhe koordinohet nga afër me Bankën Botërore. Ekipi koordinohet nga Koordinatorja për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për operacionet zhvillimore në Kosovë, e cili punon për të shfrytëzuar mandatet normative dhe ekspertizën teknike të UNKT-së për të mirën e popullit të Kosovës. Ekipi gjithashtu punon në bashkëpunim të ngushtë me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) përmes një fokusi të ndërsjellë në prioritetet e përbashkëta, veçanërisht në fushën e kohezionit social dhe ndërtimit të besimit.

Në vitin 2022, UNKT mirëpriti si një anëtar të ri, Komisionin Ekonomik të OKB-së në Evropë (UNECE), me synimin mbështetjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe ndërtimin e një platforme të dhënave për OZHQ-të në vitin 2023.

UNKT përpiqet të arrijë individët dhe komunitetet në risk për t'u lënë pas përmes një qasje bashkëpunuese të artikuluar në Kornizën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 2021–2025, e cila përcakton katër fusha të Rezultateve dhe një fushë ndërsektoriale për të hapur rrugën e Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me objektivat zhvillimore të Kosovës, Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe kriteret për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Agjencitë rezidente të OKB-së në Kosovë:



Agjencitë jo-rezidente të OKB-së:




Institucionet Financiare Ndërkombëtare:



Partnerët kyç zhvillimorë të UNKT-së në Kosovë janë qeveria e Kosovës, qeveritë donatore dhe agjencitë zhvillimore, institucionet financiare, shoqëria civile, sektori privat, bota akademike, mediat dhe populli i Kosovës. Pa to, rezultatet e paraqitura në këtë raport nuk do të ishin të mundshme. Të gjithë juve, ju shprehim falënderimet në emër të të gjithë familjes së OKB-së në Kosovë.

Falënderime të veçanta i dedikohen qeverisë dhe ministrive të ndryshme të linjës, Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kuvendit, si dhe autoriteteve komunale. U jemi veçanërisht mirënjohës partnerëve tanë të përkushtuar zbatues të cilët pa u lodhur udhëhoqën aktivitetet në mbarë Kosovën dhe natyrisht donatorëve bujarë që mbështetën nismat e UNKT-së. 5 kontribuesit kryesorë të UNKT-së në vitin 2022 ishin Bashkimi Evropian dhe qeveria e Kosovës, të pasuar nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Suedisë dhe Luksemburgut. Donatorët përfshinë gjithashtu kontribues në nivel global, të cilët siguruan mbështetje për aktivitetet e UNKT-së përmes Fondit të Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Paqes dhe Fondit të Mirëbesimit me Udhërrëfyesin për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor.





“Që të arrihen qëllimet, të gjithë duhet të bëjnë pjesën e vet. Bashkohu me ne!”

Erika, fëmijë hero i OZHQ-ve

Foto nga: © Samir Karahoda për UNICEF 2022

Të gjithë juve, ju faleminderit.

	Austria		Luksemburgu
	Kanadaja		Holanda
	Danimarka		Norvegjia
	Bashkimi Evropian		Mbretëria e Bashkuar
	Gjermania		SHBA
	Italia		Rumania
	Japonia		Suedia
	Kuvajti		Zvicra




Kapitulli 1:
Zhvillimet kyçe në Kosovë dhe konteksti rajonal



Konteksti i përgjithshëm në vitin 2022

Në vitin 2022, Kosova tregoi reziliencë në përballimin e sfidave ekonomike që prekën të gjithë rajonin, por gjatë vitit 2023 do të vazhdojë të ketë nevojë për zbutje të efekteve që rrjedhin nga lufta në Ukrainë përmes politikave të përgjegjshme. Vlerësimet tregojnë se pas rritjes së dukshme për më shumë se 10% në vitin 2021, rritja reale e bruto prodhimit vendor të Kosovës në vitin 2022 u ngadalësua në 2.5-3%. Ka pasur rritje në shkallën e punësimit, por me vetëm 31.3% të popullsisë në moshë pune të punësuar në vitin 2021 (16.5% gra), tregu i punës në Kosovë vazhdon të jetë më i dobëti në rajon.

Banka Botërore vlerëson se, si rezultat i performancës së fortë ekonomike të Kosovës në vitin 2021, varfëria u ul në 25% në vitin 2022. Megjithatë, inflacioni i vazhdueshëm (i cili arriti në më shumë se 11% në 2022) mund t'i vërë në rrezik arritjet e tilla. Më 27 tetor, Komisioni Evropian njoftoi mbështetjen për Kosovën për të zbutur ndikimin e krizës energjetike tek më të cënueshmit, me vlerë të përgjithshme prej 75 milionë eurosh, të formalizuar në shkurt 2023. Në vitin 2022, shqetësimet më të mëdha për popullin e Kosovës ishin papunësia, varfëria dhe çështjet mjedisore. Korrupsioni ishte zhdukur për herë të parë nga lista e tri shqetësimeve kryesore.



Burimet: Transparency International, Reporteri pa Kufij, The Heritage Foundation, Vision of Humanity, Freedom House, Agjencia e Statistikave të Kosovës

Politikisht, viti 2022 u dominua nga një përshkallëzim i tensioneve mes Beogradit dhe Prishtinës. Seria e acarimeve në lidhje me regjistrimin e targave, të drejtat e pjesëmarrjes në zgjedhje, shpronësimet dhe operacionet policore, kulmuan me dorëheqjen masive të rreth 3,500 serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në muajin nëntor.

Kjo, nga ana tjetër, krijoi një vakum sigurie dhe hendek në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në veri të Kosovës. Marrëveshja e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në dhjetor 2022 ofron njëfarë momentum për de-përshkallëzimin në vitin 2023, veçse potenciali për instrumentalizimin e ankesave nga të dyja palët mbetet i lartë. Në të gjitha këto, Dialogu i BE-së ka mbetur çuditërisht i verbër nga pikëpamja gjinore, me gratë që janë të nën-përfaqësuara në procesin zyrtar të negociatave. Megjithatë, një gjeneratë e re e grave në pozita kyçe politike i ka ndryshuar qëndrimet e publikut dhe ka krijuar momentum për leadershipin e grave. Progresi në buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore u ka lejuar autoriteteve të marrin parasysh nevojat specifike të burrave dhe grave në vendimmarrjen e tyre.

Viti 2022 solli gjithashtu reforma legislative për dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, por dështim i vazhdueshëm i zbatimit është pengesë për progresin real. 2,757 raste të dhunës në familje u raportuan në vitin 2022, me dy femicide shumë të bujshme vetëm në muajin dhjetor. Ndërkohë, funksionimi i tetë strehimoreve mbetet në rrezik për shkak të mungesës së fondeve të qëndrueshme, dhe sulmet verbale gjithnjë e më të zëshme ndaj grave në jetën publike pasqyrojnë dominimin e vazhdueshëm të vlerave patriarkale dhe mizogjinisë. Në të njëjtën kohë, Kosova e zgjati për tre vjet të tjera mandatin e komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin.

Pjesërisht në përgjigje ndaj tensionit të shtuar gjeopolitik pas pushtimit rus të Ukrainës, Kosova dorëzoi aplikime për anëtarësim në Këshillin e Evropës (12 maj), Bashkimin Evropian (15 dhjetor) dhe zyrtarisht shprehi aspiratën për anëtarësim në NATO (27 shkurt). Ndërkohë, BE filloi negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe i dha statusin kandidat Bosnjë dhe Hercegovinës. Në kuadër të Procesit të Berlinit, më 3 nëntor u nënshkruan marrëveshje rajonale që lehtësojnë lëvizjen ndërkufitare të qytetarëve dhe integrimin e tregjeve të punës të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kosova vazhdon të shërbejë si pikë tranziti përgjatë rrugës së migrimit të Ballkanit Perëndimor dhe po bëhet një destinacion në zhvillim për migrimin për motive punësimi, duke përfshirë edhe nga Azia Juglindore, ndërkohë që përballet me nivele të larta të emigrimit, veçanërisht të të rinjve të vendit. Qeveria ka ofruar gjithashtu qëndrim të përkohshëm për arsye humanitare për shtetas ukrainas dhe afganë.

Në nëntor, u miratua Deklarata e Shkupit për qeverisjen e qëndrueshme të migracionit në Ballkanin Perëndimor, e plotësuar me një sërë strategjish dhe ligjesh, që së bashku promovojnë bashkëpunimin rajonal për trajtimin e migracionit në mënyrë gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme, humane dhe të rregullt.

Viti 2022 dëshmoi gjithashtu progres modest drejt reformave kritike në skemën e ndihmës sociale, financimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale dhe rishikimin e propozuar të Kodit Penal për të vendosur dënime më të ashpra për veprat e sulmeve seksuale, por këto kanë ngecur. Vonesat në miratimin e udhëzimeve për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve kanë ndikuar negativisht në ofrimin e shërbimeve për fëmijët e cënueshëm, të cilët përballen me privime të shumta sa i përket shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale. Pavarësisht rritjes së mirëpritur të buxhetit për kujdesin parësor shëndetësor, treguesit e shëndetit të fëmijëve mbeten ndër më të këqijtë në rajon, duke përfshirë shkallën e vdekshmërisë së fëmijëve dhe shkallën e imunizimit. Pesë javët që shkolla u mbyllën në vitin 2022, i përkeqësuan rezultatet e ulëta të të nxëniet dhe shkathtësive, të cilat ndikojnë negativisht në tranzicionin nga shkolla në punë për të rinjtë dhe veçanërisht gratë e reja. Sipas një raporti të Avokatit të Popullit, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë komuniteti më i marginalizuar në Kosovë, por një vendim gjykatë i marrë në muajin tetor, i cili e bën Komunën e Prishtinës përgjegjëse për dështimin në ofrimin e infrastrukturës publike të qasshme, ofron një momentum për ndryshim. Qeveria ka njoftuar se do të ndërmarrë regjistrimin e ardhshëm të popullsisë dhe ekonomive familjare në 2023, duke kërkuar në mënyrë aktive pjesëmarrjen e popullsisë në komunat me shumicë serbe të Kosovës.

Komisioni për verifikimin e diplomave universitare të marra në sistemin arsimor serb, i cili kishte pushuar së funksionuari më 31 dhjetor 2021, vazhdoi të ishte jo-funksional deri në dhjetor 2022, duke penguar qasjen në arsim dhe punësim për disa pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë. Marrëveshjet rajonale të nënshkruara më 3 nëntor përfshijnë edhe një zotim për njohjen reciproke të diplomave të arsimit të lartë. Ratifikimi i shpejtë i marrëveshjes nga Kuvendi i Kosovës më 23 shkurt 2023 është shumë i mirëpritur në këtë drejtim.

Më 19 shtator, qeveria ndërmori një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të jetës së komuniteteve të cënueshme duke prezantuar Strategjinë e re për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026. Së bashku me Planin Kombëtar për Zhvillim (të miratuar në mars 2023) dhe Strategjinë e re të Arsimit, këto dokumente paraqesin një mundësi kritike për të realizuar të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe për të siguruar që ato të mos mbeten prapa gjatë zbatimit të Agjendës 2030 dhe arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.



Kapitulli 2:
Mbështetja e sistemit zhvillimor të OKB-së
për prioritetet zhvillimore të Kosovës



Korniza e Bashkëpunimit

Korniza e Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025 përcakton pesë fusha prioritare dhe Rezultati, duke reflektuar vizionin dhe synimet zhvillimore të Kosovës, krahas strategjisë së nevojshme për t'i arritur këto dhe për të ecur drejt OZHQ-ve. Të mos lëmë askënd mbrapa dhe të arrijmë tek që janë më të prapambetur, janë temat e përbashkëta që i lidhin të gjitha përpjekjet e OKB-së në Kosovë, në të pesë fushat e Rezultateve. Rezultati e pestë, për barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e barabartë, është një temë ndërsektoriale e lidhur me të gjitha fushat prioritare.

Përmes ofrimit të udhëzimeve dhe këshillave për zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe nismave, si dhe trajnimeve, punëtorive, sesioneve për rritjen e vetëdijesimit, përpjekjeve për angazhimin e komunitetit, sistematizimit dhe digjitalizimit të të dhënave, Ekipi i OKB-së në Kosovë mbështeti rimëkëmbjen ekonomike, pjesëmarrjen, dhe shërbime transparente, efektive dhe të drejta, si dhe forcoi vëmendjen e qeverisë për llogaridhënien, përfshirjen, pjesëmarrjen dhe kohezionin social në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.


Në qendër të të gjitha përpjekjeve të veta, Ekipi i OKB-së në Kosovë mbështeti zhvillimin e Planit Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm (miratuar në mars 2023), duke rritur përafrimin e Planit me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Plani e përcakton gjithëpërfshirjen si çelësin për arritjen e objektivave të katër shtyllave të veta të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; zhvillimin e barabartë njerëzor; sigurinë dhe sundimin e ligjit; dhe qeverisjen e mirë, të cilat pasqyrohen në Kornizën e Bashkëpunimit të Kombeve të Bashkuara.



Fushat Prioritare të Kornizës së Bashkëpunimit



Përafrimi i PKZH-së me Kornizën e bashkëpunimit dhe OZHQ-të



Korniza e OKB-së për Bashkëpunim

Plani Kombëtar për Zhvillim

Thyerja e kodit: Si mund të çlirohet transformimi nga prioritizimi i barazisë gjinore në vendimmarrjen publike

Kur autoritetet marrin vendime se si të ndajnë resurse për komunitetet e tyre, është e rëndësishme të mendojmë për nevojat specifike të grave dhe vajzave. Në vitin 2020, Kosova iu bashkua një programi rajonal të OKB-së për financimin transformues përmes të cilit zyrtarët u trajnuan për mjetet "me përgjegjshmëri gjinore". Studimi i fizibilitetit nga Agjencia për Barazinë Gjinore hapi rrugën, në vitin 2022, për kornizën e parë rregullatore që integron nevojat e grave dhe vajzave në të gjithë planifikimin dhe buxhetimin e qeverisë. Kjo u pasua me nisma të mëtejshme.

Kopshtet publike për fëmijë revolucionarizojnë peisazhin e punësimit

Një analizë gjithëpërfshirëse gjinore në komunën e Gjakovës tregoi se një faktor kyç që pengon pjesëmarrjen e grave në tregun e punës ishte mungesa e shërbimeve të qasshme dhe të përballeshme për kujdesin ndaj fëmijëve. Krijimi i kopshteve do të ishte vendimtar për ta adresuar këtë pengesë. Në vitin 2021 u ndërtuan me sukses dy kopshte publike, investimi i parë i këtij lloji që nga viti 1981. Në vitin 2022 u iniciuan përpjekje të mëtejshme për të zhvilluar dy objekte shtesë dhe, nëpërmjet bashkëfinancimit, potencialin për të ndërtuar edhe më shumë kopshte për fëmijë dhe për të rikthyer kështu gjithnjë e më shumë gra në punë.



"Një vend gjykohet nga vendi që u jep grave, kështu që le të sigurohemi që asnjë grua të mos mbetet pas".

Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës

Fusha Prioritare 1: Qeverisja Llogaridhëse

Kryesuar nga UNDP-ja me UNHCR-në me pjesëmarrje tëILO, IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UN-Habitat, UNHCR, UNICEF, UNODC, UN Women



Viti 2022 dëshmoi përmirësime të dukshme në qeverisjen e mirë në Kosovë. Perceptimi publik u përmirësua. Sipas Anketës së Pulsit Publik të UNDP-së, numri i qytetarëve që mendojnë se vendimmarrja në institucione është gjithëpërfshirëse dhe llogaridhëse (OZHQ 16.7.2) u rrit ndjeshëm nga 6.7% në 2019 në 22.5% në 2022 (gra: nga 7.5% në 22.9%, burra: nga 5.9% në 22.4%). Të kënaqurit me performancën e institucioneve të Kosovës (OZHQ 16.6.2) u rritën nga 22% në 2019 në 45.9% në 2022 (gra: nga 20.7% në 47%, burra: nga 18.6% në 45.2%).



Anketa e Pulsit Publik nga UNDP Skano këtu

UNKT (duke përfshirë IOM dhe UN-Habitat) mbështeti këto arritje, duke zhvilluar kapacitetet e institucioneve për t'u bërë më gjithëpërfshirëse, më të përgjegjshme dhe transparente. 14 komuna kanë mekanizma dhe platforma digjitale më të avancuara për t'u angazhuar me banorët dhe shoqërinë civile. Tri institucione qendrore shtesë kanë rritur kapacitetet e tyre dygjuhëshe për t'i bërë shërbimet të qasshme për të gjitha komunitetet. Qendra e Gjuhëve në Prishtinë, e themeluar në vitin 2021, vazhdoi të shërbejë si institucion certifikues për përkthyes dhe interpretë profesionistë gjyqësorë, si dhe ofroi kurse të gjuhës zyrtare për 2,300 studentë të gjuhëve dhe nëpunës civilë.

Kosova përjetoi rritje të dukshme të grave në pozitat vendimmarrëse në nivel qendror (OZHQ 5.5.1) pas zgjedhjeve të vitit 2021. Ndërkohë, UNKT (duke përfshirë UNDP-në dhe UN Women) mbështeti institucionet qendrore dhe lokale që të bëhen më të përgjegjshme ndaj gjinisë në vitin 2022 (OZHQ 5.c.1): Në nëntor, qeveria miratoi Konceptin e saj të parë të Buxhetimit me Përgjegjshmëri Gjinore dhe lansoi hartimin e kornizës rregullatore. Rreth 122 zyrtarë janë tashmë të pajisur më mirë për t'i integruar çështjet gjinore në proceset e tyre të programimit dhe buxhetimit, çka çoi në miratimin e katër Kornizave Buxhetore Afatmesme Komunale me përgjegjshmëri gjinore. Institucionet e Kosovës gjithashtu iu bashkuan një nisme rajonale për të kryer për herë të parë Auditim Paralel Gjinor.



46% Kënaqshmëria me institucionet u rrit nga **22%** (2019)



122 zyrtarë të pajisur për të integruar gjininë në proceset e programimit dhe buxhetimit



Më shumë se **4,000** zyrtarë kanë bërë deklaram të pasurisë nëplatformën online të mbështetur nga OKB

Renditja e fundit e Kosovës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, zbulon përmirësime të rëndësishme në perceptimet ndaj korrupsionit në sektorin publik (OZHQ 16.5.1): Kosova ka avancuar 17 vende në krahasim me vitin 2019, duke u ngjitur në vendin e 84-të në botë. Mbështetja e agjencive të OKB-së (duke përfshirë UNODC dhe UNDP) për ngritjen e kapaciteteve dhe hartimin e legjislacionit kontribuoi në përparimin e qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe flukseve të paligjshme financiare, si dhe në zbatimin e masave për rikuperimin e aseteve (OZHQ 16.4). Miratimi i ligjeve kyçe që përbëjnë pjesë të Agjendës së Reformave Evropiane të Kosovës rriti transparencën dhe saktësinë në raportimin e shpalosjeve financiare, forcoi mekanizmat e mbikëqyrjes dhe racionalizoi procedurat për sanksionimin e shkeljeve - duke përfshirë Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë (miratuar në shkurt 2023), dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike (miratuar në dhjetor 2022). Miratimi i këtij ligji të fundit në veçanti vlerësohet se e ka meritën për përmirësimin e rezultatit nga Transparency International.

U hartua një Udhërrëfyes për Rikuperimin e Aseteve në përputhje me Konventën e OKB-së Kundër Korrupsionit si dhe një Udhërrëfyes për Armët e Vogla dhe të Lehta. Gjykata Supreme miratoi Udhëzimet për Politikën Ndëshkimore për veprat e korrupsionit. Zyra e Prokurorisë Speciale i përmirësoi kapacitetet e veta për të trajtuar rastet e korrupsionit dhe mbi 4,000 zyrtarë publikë përdorën për herë të parë një platformë online të mbështetur nga OKB-ja për deklaram të pasurisë.

Të dhënat paraprake tregojnë progres në qasjen në drejtësi për personat e cenusëshëm (OZHQ 16.3). 200 raste kanë përfituar ndihmë juridike nga klinika mobile dhe 240 persona (50% gra) janë ndihmuar për qasje në drejtësi kryesisht për të përfunduar procedurat e vonuara të regjistrimit të lindjes, për të marrë statusin e pashtetësisë ose për të adresuar pretendimet për të drejtat pronësore dhe pensionale. 25 të mitur me probleme ligjore përfituan nga programi UPSHIFT në një Qendër Edukuese dhe Korrektuese për riintegrimin e tyre në shoqëri, ndërsa gjithsej 766 të kthyer vullnetarë jo-shumicë dhe persona të zhvendosur brenda vendit përfituan nga trajnimi për shkathtësi.

Puna e prokurorëve të Kosovës në një operacion kompleks të pastrimit të parave u vlerësua nga Egmont Group, një organizatë globale e njësive kombëtare për inteligjencë financiare, e cila theksoi si sukses:

- konfiskimin më të madh të aseteve në Kosovë deri më sot (1 milion euro)
- bashkëpunimin taktik me sektorin privat, prokurorinë dhe autoritetet tatimore e doganore
- shkëmbimin e informacionit me 17 anëtarë të Grupit Egmont
- kohën rekord të përfundimit prej 18 muajsh nga depozitimi i raportit të transaksionit të dyshimtë deri në vendimin e gjykatës
- kontaktin proaktiv për të kompensuar viktimat e kombësive të tjera me fonde të konfiskuara



Rastet më të mira nga Egmont Skano këtu

Gjykatës Themelore në Prishtinë i është siguruar mbështetje në ofrimin e shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit, dhe 6,500 dosje të lëndëve gjyqësore nga të shtatë Gjykatat Themelore janë regjistruar për digjitalizim. Dokumentet ligjore dhe të politikave me implikime në të drejtat e njeriut janë shqyrtuar, dhe kanë përfituar nga komentet ose mbështetja për hartim nga UNKT, (përfshirë IOM, ILO, OHCHR, UNDP, UNICEF, UN Women), duke përfshirë Strategjitë për drejtësinë tranzicionale, për komunitetet rom dhe ashkali, për të drejtat e komuniteteve dhe për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe Ligji i rishikuar për liritë fetare. U rishikuan kurrikulat e arsimit për të miturit në konflikt me ligjin për t'u përshtatur me legjislacionin dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. UNKT gjithashtu ka vazhduar mbështetjen e shoqërisë civile për të monitoruar dhe raportuar për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në vitin 2022, Kosova gjithashtu vazhdoi të zhvillojë legjislacion dhe politika të reja për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje dhe DhBGj-së, përfshirë dhunën seksuale. U lansua Protokollin i Qeverisë për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Ligji i ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje u finalizua dhe u dorëzua zyrtarisht në Kuvend në muajin tetor. Projektligji për Kodin Penal do të ashpësojë dënimet dhe do të mbrojë gratë dhe vajzat nga dhuna në jetën publike.



Dyshimet e një nëne të re zbuten nga vizitat mjekësore në shtëpi

Individët dhe familjet në zona të thella përfitojnë nga një program i UNICEF-it për vizita në shtëpi, i mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut, i cili sjell infermierë në shtëpitë e tyre për të ofruar mbështetje dhe këshilla mjekësore, duke ofruar informacionin shëndetësor dhe mbështetje emocionale. Nëna e re Jehona ishte e pasigurt kur filloi ta ushqente fëmijën e saj me gji, por fitoi njohuri dhe, bashkë me to, besimin si nënë. Foshnja e saj u zhvillua në një djalë të shëndetshëm. Prej vitit 2014, mbi 67,000 fëmijë dhe 15,000 gra shtatzëna kanë përfituar nga vizitat në shtëpi të kryera nga 1,960 profesionistë shëndetësorë.



"I kontaktoja motrat për gjithçka, madje edhe për detaje të vogla kur dyshoja për diçka, dhe ato më qetësonin dhe më tregonin çka të bëja."

Jehona, nënë nga Vushtrria e cila ka përfituar nga vizitat në shtëpi



"Unë nuk kam shkuar në shkollë. Babai im mendonte se ishte e panevojshme... Bija ime do të mësojë shkrim e lexim, dhe unë do të bëj të pamundurën që t'ia mundësoj këtë."

Arieta Bajrami
nënë vetë-ushqyese nga Graçanica

Foto nga: © UNICEF 2022

Foto nga: © Arben Llapashitca për UNDP 2022



Fusha Prioritare 2: Politikat dhe shërbimet sociale

Kryesuar nga UNICEF-i me OBSH-në me pjesëmarrje nga ILO, IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UN-Habitat, UNODC, UNOPS



Gjatë vitit 2022, agjencitë e Kombeve të Bashkuara (duke përfshirë UNFPA, UNICEF, UNOPS dhe OBSH) mbështetën qeverinë në zbatimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe programeve të imunizimit (OZHQ 3.c.1, 3.b.1 dhe 3.b.3) përmes punës me politikën, përmirësimeve të infrastrukturës dhe zhvillimit të kapaciteteve, duke lejuar mbrojtjen e më të cenueshmeve: Ato ndihmuan në hapjen e platformës "GoData", duke u lejuar autoritetet të mbledhin dhe shfaqin të dhëna të besueshme dhe cilësore në kohë reale. Sigurimi i një sistemi të gazit mjekësor në gjashtë spitale përmirësoi infrastrukturën e përgjithshme shëndetësore dhe, në përgjigje të mungesës së energjisë, u dhuruan shtatë gjeneratorë për të mbështetur shërbime të pandërprera. Rreth 600 profesionistë të kujdesit shëndetësor, politikëbërës dhe vendimmarrës kanë përfituar nga përmirësimi i kapaciteteve të tyre. UNKT-ja këshilloi për legjislacionin që rrit qasjen në barna të sigurta dhe cilësore. Të gjitha komunat kanë zhvilluar plane për gatishmëri dhe reagim ndaj emergjencave. Ministria e Shëndetësisë dhe komunat zgjeruan programin e vizitave në shtëpi për të mbuluar të 38 komunat e Kosovës (OZHQ 3.c.1). Mbi 16,000 fëmijë, ose rreth 70% e grupit të lindjes, përfituan nga 37,355 vizita në shtëpi, duke mbështetur zhvillimin e shëndetshëm, ushqimin adekuat, mirëqenien e prindërve dhe prindërimin e përgjegjshëm. Ministrinë e Shëndetësisë dhe Financave kanë ndarë një buxhet për vizitat në shtëpi (3.2 milionë euro) për vitin 2023. Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, me mbështetjen e OKB-së, ka finalizuar një hulumtim për shëndetin seksual dhe riprodhues, i cili zbuloi shkelje sistematike të të drejtave të grave dhe vajzave dhe nxori 528 rekomandime. Reagimi efektiv ndaj pandemisë COVID-19 u mbështet përmes gjenerimit të kërkesës për vaksina, pikave të përkohshme të vaksinimit dhe sigurimit të tetë automjeteve frigoriferike për shpërndarjen e vaksinave, si dhe përmes përmirësimit të sistemit të zinxhirit të ftohtë dhe ndërtimit të magazinimit qendror të vaksinave. Gjithsej 734,000 vaksina u dhuruan përmes instrumentit COVAX të lehtësuar nga OKB-ja.



734,000 vaksina kundër COVID-19 të dhuruara nga COVAX me lehtësim nga OKB-ja



Mbi 16,000 fëmijë (70% e grupit të lindjes) kanë përfituar nga 37.355 vizita shëndetësore në shtëpi



10,309 familje jetojnë në varfëri ekstreme përfituar nga programi i ndihmës me kupon ose shërbime komunale

Kombet e Bashkuara, me udhëheqjen teknike nga UNICEF, ofruan gjithashtu mbështetje për zhvillimin e politikave, këshilla për hartimin e legjislacionit, rritjen e vetëdijesimit, si dhe shërbime për rritjen e kapaciteteve për autoritetet - për të forcuar arsimin (OZHQ 4.2.2): Edukimi në fëmijëri të hershme dhe digjital janë përfshirë në vitin 2022 si shtylla kyçe në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2022-2026 dhe si komponentë thelbësorë të Planit të ri Kombëtar për Zhvillim të Kosovës.

Ligji gjithëpërfshirës për edukimin në fëmijëri dhe hershme u prezantua në Kuvend. Një ndarje e shtuar buxhetore prej 5.8 milionë euro për vitin 2023 do të zgjerojë infrastrukturën parashkollë (OZHQ 4.2.1), e mbështetur nga një kurrikulë bërthamë e forcuar dhe modele alternative të qendrave të mësimnxënies së hershme për fëmijët më të cenueshëm. Rreth 670 edukatorë kanë zhvilluar kapacitete të zgjeruara, ndërsa një aplikacion digjital i shkarkuar nga mbi 10,000 përdorues (19% burra) u ofroi prindërve kosovarë mbështetje prindërore në shqip dhe serbisht. Vlerësimi i Strategjisë së Kosovës për Rininë 2018-2023 u ndihmoi autoritetet të demonstrojnë llogaridhënie dhe të mbështesin vendimmarrjen e bazuar në dëshmi.

Anëtarët e Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (duke përfshirë ILO, IOM, OHCHR, UNDP, UN-Habitat, UNICEF dhe UN Women) mbështetën aspiratat e qeverisë për të reformuar sistemin e mbrojtjes sociale dhe shërbimet sociale të Kosovës duke ndihmuar në rishikimin e kornizës ligjore dhe zhvillimin e rrugëve për digjitalizim, kryerjen e analizave të politikave dhe zhvillimin e kapaciteteve, dhe duke punuar me shoqërinë civile për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të caktuara: Qeveria hartoi një ligj të ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare; Ligjin për të Huajt; dhe një ligj personat me aftësi të kufizuara me mbështetjen e UNKT-së, i cili ka bërë progres të mirë në agjendën legjislative për vitin 2023.

Zhvillimi i legjislacionit dytësor kritik për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve mundësoi krijimin e mekanizmave të rinj për të drejtat e fëmijëve në nivel lokal përmes krijimit të ekipeve për të drejtat e fëmijëve në njëmbëdhjetë komuna. (OZHQ 16.2) Rreth 170 zyrtarë rritën kapacitetet për të ofruar shërbime sociale sipas kornizës së re ligjore.

Në mënyrë të ngjashme, u forcuan aftësitë për ofrim të shërbimeve nga Qendrat për Punë Sociale përmes angazhimit të 40 vullnetarëve të OKB-së; në 12 qendra rehabilitimi me bazë komunitare që ofrojnë shërbime multidisiplinare për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara; dhe në strehimore të cilat kolektivisht u shërbejnë deri në 850 të mbijetuarave dhe fëmijëve të tyre. Si rezultat, 349 fëmijë me aftësi të kufizuara (221 vajza) përfituan drejtpërdrejt nga shërbimet e rehabilitimit, ndërsa prindërit dhe kujdestarët e tyre (292 gra dhe 55 burra) rritën kapacitetet e tyre për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve të tyre. Ekipet për të drejtat e fëmijëve identifikuan 71 fëmijë (34 vajza, 37 djem) në situatë rruge dhe 40 nga prindër që u referuan në qendrat e kujdesit ditor dhe në programet e prindërimit.

8,290 familje që jetojnë në varfëri ekstreme (3,834 prej tyre familje me kryefamiljare gra dhe 859 familje minoritare) përfituan nga një skemë inovative me kuponë në të 38 komuna, ndërsa 2,019 familje të tjera (1,029 prej tyre me kryefamiljare gra) përfituan nga mbështetja e shërbimeve komunale. Katër klinika mobile u ndihmuan mbi 918 të moshuarve, grave dhe të rinjve në zonat rurale me shërbime sociale, juridike dhe shëndetësore. 16 migrantë të bllokuar dhe PZHBV u ndihmuan për t'u kthyer vullnetarisht dhe për t'u riintegruar në shtëpitë e tyre (OZHQ 10.7), dhe 35 familjeve (179 individë) që zgjedhën të kthehen në Kosovë, iu ofruan zgjidhje të qëndrueshme. U rritën kapacitetet e autoriteteve që menaxhojnë një qendër të pritjes, e cila ofron strehim dhe shërbime bazë për migrantët, duke adresuar rritjen e numrit të mbërritjeve përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor. U krijua gjithashtu një linjë informacioni e qasshme për të lidhur migrantët me resurset e nevojshme. Me ndihmën e OKB-së, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve hartoi pesë udhëzime administrative, të cilat hapin rrugën për menaxhim të digjitalizuar të rasteve për ofruesit e shërbimeve sociale për të zëvendësuar sistemin aktual me shkresa fizike. Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka zhvilluar një Studim Fizibiliteti për Banim Adekuat Social me ndihmën e OKB-së, i cili do të veprojë si kornizë për zhvillimin e një programi për banim të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm (OZHQ 11.1, 11.3, 11.5, 11.7, 11. 11.b, 11.c).

Nxitja e inovacionit të gjelbër: Programi i Përshpejtimit i shtyn bizneset e vogla drejt suksesit të qëndrueshëm!

Në vitin 2022, UNDP prezantoi programin e vet BOOST x Kosovo për t'u ofruar 50 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga e gjithë Kosova mundësinë për të përfituar nga një program përshpejtues tremujor, duke fituar shkathtësi dhe njohuri për udhëheqësi, biznes dhe transformimin e gjelbër. 15 ndërmarrje të përzgjedhura morën gjithashtu grante deri në 20,000 euro për të mbështetur zgjidhje inovative. Këto përfshijnë teknikat e menaxhimit të mbetjeve në bujqësi dhe prodhimin e ushqimit, prodhimin ekologjik dhe të gjelbër, aplikimin e parkimit inteligjent, reduktimin e kthimeve të tregtisë elektronike duke përdorur Inteligjencën Artificiale, si dhe prodhimin e modës digjitale për zgjidhjen e mbikonusimit dhe mbiprodhimin.

Havushja dhe vajza e saj adoleshente, Erblina, u përzgjedhën për një program përshpejtimi gjashtëmujor për të vënë në zbatim projektin e tyre, Greenergy, duke përdorur mbetjet nga prodhimi organik për të prodhuar erëza organike të certifikuar, të përballueshme dhe të qëndrueshme. Si një nga gratë e para në Kosovë që përdori produkte pyjore jo-drunore dhe si pronare e një prej bizneseve të pakta në Kosovë me certifikim organik, Havushja themeloi 99lule, së bashku me rreth 50 gra të tjera që shesin bimë mjekësore dhe aromatike. Produktet e 99lule shiten në supermarkete, barnatore dhe restorante anëmbanë Kosovës dhe eksportohen në Evropë.



"Kompania jonë është rritur në mënyra të shumanshme. 50% e operacioneve tona ditore tani mundësohen nga energjia solare dhe faturat e energjisë na janë ulur që atëherë."

Havushje, themeluese e kompanisë 99Lule dhe përfituese e një programi përshpejtues gjashtëmujor

Foto nga: Rina Abazi për UNDP-në 2022

Fusha Prioritare 3: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik

Kryesuar nga UNDP me UN-Habitat-in me pjesëmarrje nga FAO, ILO, IOM, UNEP, UNICEF, UN Women, UNV, OBSH



Duke kontribuar në avancimin e kushteve të punës (OZHQ 8.8.2), Ekipi i OKB-së në Kosovë (duke përfshirë FAO, ILO, UNDP dhe UN Women) mbështeti zhvillimin e dokumenteve të politikave, ofroi shërbime për ngritjen e kapaciteteve, si dhe organizoi fushata për rritjen e vetëdijesimit. Politika është përkthyer me sukses në formën e Strategjisë për Zhvillim të Inspektoratit të Punës 2023–2027; veç kësaj, projektligjet për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe për Inspektoratin e Punës kanë avancuar me potencial për miratim në vitin 2023. 200 përfaqësues nga profesione të ndryshme ngritën kapacitete për parandalimin e ngacmimeve seksuale dhe për politika miqësore ndaj familjes në vendin e punës, duke mbështetur mekanizmat parandalues. 38 palë të interesit lokale ngritën sfida dhe shqetësime në vendet e tyre të punës nëpërmjet ndërveprimit të drejtpërdrejtë me Avokatin e Popullit, duke nxitur një raport hulumtues të Avokatit të Popullit ngacmimin seksual në vendet e punës publike dhe private. Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë dhe PricewaterhouseCoopers iu bashkuan komunitetit të mbi 7,000 bizneseve anëmbanë globit si dy nënshkruese të reja të Parimeve të Fuqizimit të Grave. Shtatë kompani të sektorit privat po ndryshojnë politikat dhe praktikën e tyre të brendshme për të qenë vende pune më miqësore me familjen, duke ofruar kushte dhe përfitime më të mira pune për 656 punonjës, çka pritet të ndihmojë në uljen e hendekut gjinor (OZHQ 5.4.1). Kërkohej më shumë kohë për të vëzhguar përmirësime më të mëdha në kushtet e punës. Për të kontribuar në uljen e shkallës së lartë të të rinjve jo në punësim, arsim, trajnim (NEET) (OZHQ 8.6.1), e cila aktualisht është në nivelin prej 32%, anëtarët e Ekipit të OKB-së në Kosovë (duke përfshirë ILO, UNDP, UNICEF) ofruan mbështetje teknike për hartimin, zbatimin dhe ushtrimet e ofrimit të shërbimeve, dhe nxiti programe inovative për praktika dhe mentorim.



7 kompani të sektorit privat të përkushtuar ndaj vendeve të punës miqësore me familjen



1,500 përfitues përfituan nga masat e tregut aktiv të punës



60 hektarë tokë pyllëzuar me 180,000 fidanë



Agjencitë e Kombeve të Bashkuara ofruan mbështetje teknike shumë të specializuar për qeverinë për përgatitjen e Planit të parë të Kosovës për Zbatimin e Garancisë për të Rinjtë, të cilin qeveria e miratoi në vitin 2022 dhe pritet të fillojë të zbatohet në vitin 2023, si dhe për hartimin e Strategjisë për Tregun e Punës dhe Punësimin 2023–2028. Nga masat e tregut aktiv të punës të ofruara nga Agjencia Publike e Punësimin, me asistencë teknike nga OKB, përfituan rreth 1,500 përfitues kryesisht nga grupet e cenueshme. 220 të rinj – 10% nga komunitetet jo-shumicë dhe 5% me aftësi të kufizuara – kanë kryer praktikën përmes Kosovo Generation Unlimited; 30% të të gjithë praktikantëve iu ofrua punësim me orar të plotë në fund të praktikës së tyre. 9,401 punëkërkuar të rinj dhe 532 punëdhënës u regjistruan në platformën online K-GenU të zhvilluar për përputhjen e të rinjve që kërkojnë përvojë pune në kompani, shoqëri civile dhe institucione publike.

Përpjekjet afatgjatë të avokimit dhe puna e vazhdueshme për përmirësimin e politikave kanë ndikuar pozitivisht në qasjen e grave në resurset ekonomike. Gjatë viteve të fundit janë parë përmirësime të lehta në përqindjen e pronave në pronësi të grave (OZHQ-të 1.4 dhe 5.a.1-b) dhe përqindjen e bizneseve të drejtuara nga gratë, nga 17% dhe 11% në 2019 në 19% dhe 13% përkatësisht në vitin 2022. Kjo u mbështet nga dhënia e granteve nxitëse për 82 biznese të grave për të zgjeruar bizneset e tyre. Në lidhje me agjendën e gjelbër dhe digjitale si dhe reziliencën klimatike,

agjencitë e OKB-së, me udhëheqje teknike nga UNDP, mbështetën funksionalizimin e Këshillit të Kosovës për Ndryshimet Klimatike, hartimin e Ligjit të parë për Ndryshimet Klimatike, i cili prezanton kontributet vullnetare të përcaktuara në nivel kombëtar (OZHQ 13.2.1), dhe hartimin e Udhërrëfyesit të Ekonomisë Qarkore, i cili u botua në mars 2023, duke përcaktuar rrugën drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

Në nivel komunal, agjencitë e OKB-së eksploran zona për të krijuar sisteme për të dhëna për emetimet, për të përmirësuar planifikimin e investimeve dhe intervenime pilot që reduktojnë emetimet, duke përfshirë mbështetjen e dy komunave në zhvillimin e Planeve Lokale të Veprimit për Cilësinë e Ajrit. 50 biznese u mbështetën për të përqafuar tranzicionin e gjelbër përmes partneritetit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë u mbështet me praktikën më të mira të turizmit të qëndrueshëm për finalizimin e Strategjisë së Turizmit të Kosovës për periudhën 2022-2025, duke hapur shtigje të reja për ecje malore dhe duke krijuar dialog publiko-privat për një skemë të gjelbër potenciale, identitetin e brendit turistik dhe përdorimin e komunikimeve për rigjallërimin e sektorit të turizmit.

Me qëllim të përmirësimit të sektorit të pylltarisë (OZHQ-të 15.1.1 dhe 15.2.1), Ekipi i OKB-së në Kosovë, me udhëheqje teknike nga FAO, i ofroi mbështetje Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes rishikimeve të kornizës ligjore, rritjes së kapaciteteve, fushatave për vetëdijesim dhe mbështetjes me pajisje: Vendosija e një Sistemi Informativ të Pyjeve të Kosovës ka lejuar mbledhjen e të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë, ndërsa vetëdijesimi mbështeti mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve. Sigurimi i pajisjeve dhe mjeteve për mbikëqyrje më të madhe lejoi kundërveprimin ndaj aktiviteteve të paligjshme pyjore. Ministria pyllëzoi rreth 60 hektarë (ose rreth 180,000 fidanë të mbjellë) me ndihmën e UNKT-së. Ministria gjithashtu ka zhvilluar kapacitetet për shëndetin e pyjeve dhe laboratorin pyjor, ka bërë inventarizimin për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve me shumë qëllime, si dhe ka identifikuar nevojat për zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kafshëve të egra. 120 persona u trajnuan se si të përdorin siç duhet produktet me bazë pyjore dhe të zhvillojnë zinxhirët e tyre të vlerës.



Fuqizimi i Komuniteteve të Kosovës: Vullnetarët e OKB-së nxisin ndryshimin e qëndrueshëm nga brenda

Në Kosovë, OKB angazhon anëtarët e komunitetit për të mbështetur projektet e komunitetit: 64 prej tyre vetëm në vitin 2022 (85% gra, 15% anëtarë të komunitetit jo-shumicë). Kjo e bëri grupin e Kosovës një nga kontigjentet më të mëdha të vullnetarëve të komunitetit të OKB-së në Evropë. Vullnetarët fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë duke bashkëpunuar me qeverisjen lokale dhe palë të tjera lokale të interesit, duke kontribuar në fushat e punës sociale dhe ofrimit të shërbimeve të bazuara në komunitet, kohezionit social, ndryshimeve klimatike, trashëgimisë kulturore, mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave dhe fuqizimit të grave. Nga ana tjetër, ato janë në gjendje të kenë një ndikim lokal afatgjatë.

Anita Shabani dëshironte të fitonte përvojë të drejtpërdrejtë zhvillimore. Si vullnetare e komunitetit të OKB-së, Anita e ka arritur këtë objektivi, duke mbështetur programin pyjor të FAO-s. Në këtë rol, Anita po ndihmon në forcimin e menaxhimit të pyjeve në komunitetin e saj, duke përmirësuar mjetet e jetesës rurale dhe duke mbështetur përfshirjen dhe integrimin gjinor. Si grua me aftësi të kufizuara, për më tepër, Anita e përdor pozicionin e saj si vullnetare e komunitetit të OKB-së për të mbrojtur të drejtat e aftësisë së kufizuar dhe për të ndërtuar ura brenda komunitetit, duke nxitur të kuptuarit e personave me aftësi të kufizuara dhe duke demonstruar kapacitetet e personave si ajo, për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit të tyre.



“Përkundër paaftësisë, gjinisë apo prejardhjes sime, e di se jam aset i fortë për botën.”

Anita Shabani
Vullnetare e OKB-së

Foto nga: Ergin Hajredini për FAO 2022



Fusha Prioritare 4: Kohezioni social

Kryesuar nga IOM-i me UNICEF-in me pjesëmarrje nga OHCHR, UNDP, UNFPA, UN Women



Treguesit kyç të kohezionit social treguan përmirësime të dukshme në vitin 2022. Sipas Anketës së Pulsit Publik, më pak qytetarë u ndjenë të diskriminuar gjatë gjashtë muajve të mëparshëm (OZHQ 10.2.1) në vitin 2022 (4.2% e grave dhe burrave) sesa në vitin 2019 (11% në përgjithësi, me 9.5% të grave dhe 12.5% të burrave). Në mënyrë të ngjashme, pak më shumë qytetarë sot se tre vjet më parë besojnë se marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës “nuk janë aq të tensionuara” ose “nuk janë aspak të tensionuara” (OZHQ 16.b.1): 21% në vitin 2022 (shqiptarë të Kosovës 21.3%, serbë të Kosovës 25% dhe komunitete të tjera në Kosovë 15%) krahasuar me 20% në vitin 2019 (shqiptarë të Kosovës 21%, serbë të Kosovës 13% dhe komunitete të tjera në Kosovë 14%). Ekipi i OKB-së në Kosovë (duke përfshirë IOM, UNDP, UNFPA, UNICEF dhe UN Women) punoi intensivisht për të promovuar dialogun dhe ndërveprimet ndërmjet komuniteteve për të ndërtuar besimin dhe, në këtë mënyrë, për të kontribuar në kohezionin social ndërmjet komuniteteve në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. UNKT lehtësoi nisma të shumta ndëretnike, veçanërisht duke targetuar të rinjtë. Kampet rinore dhe programe të tjera ndërvepruese të lidhura me ndërtimin e paqes, gjuhën e urrejtjes, të drejtat e njeriut dhe të menduarit kritik, mblodhën së bashku më shumë se 5,000 të rinj me prejardhje të ndryshme etnike. Pjesëmarrësit ishin në gjendje të sfidonin supozimet e përbashkëta, të trajtonin narrativat përçarëse dhe të ndërtonin identitetet e tyre në një mënyrë të hapur, përtej stereotipeve etno-kombëtare.



Foto nga: ©Arben Liapashitica për UNDP 2022



Më pak qytetarë janë ndier të diskriminuar në vitin 2022 (4.2%) sesa në vitin 2019 (11%)



71,000 përdorues gjithsej në platformën për mësim të gjuhëve VocUp të sponsorizuar nga OKB-ja



5,000 të rinj të angazhuara në programet e OKB-së për ndërtimin e paqes dhe për të drejtat e njeriut

Ndikimi pozitiv i aktiviteteve të tilla u shumëfishua përmes krijimit të sinergjive rajonale, ndërkufitare nëpërmjet Projektit Rinia për Gjithëpërfshirje, Barazi dhe Besim, i mbështetur nga Fondi i Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Paqes. 150 të rinj nga Kosova dhe Ballkani Perëndimor u mblodhën në Asamblenë e 4-të Rinore të Kombeve të Bashkuara në qershor, një bashkëpunim midis Misionit të OKB-së në Kosovë dhe ekipit të OKB-së në Kosovë, për të diskutuar sfidat që lidhen me rininë, paqen dhe sigurinë në epokën digjitale. Asambleja jo vetëm që ofroi mundësi bashkëpunimi midis të rinjve aktivë në mbarë Ballkanin Perëndimor, por gjithashtu kremtoi edhe përfshirjen aktive të nëntë avokuesve të rinj për aftësitë e kufizuara. Shndërrimi i një biblioteke të mëparshme në një hapësirë të re ndërdisiplinore bashkëpunimi për programim artistik, arsimor dhe komunitar (“Qendra për Praktikë Narrative”) vazhdon të ofrojë mundësi të shumta për ndërveprim ndëretnik. Ndërkohë, mbi 71,000 përdorues individualë u regjistruan në platformën për mësim të gjuhëve VocUp, duke demonstruar përkushtimin dhe vullnetin e tyre për të komunikuar në njërin nga dy gjuhët zyrtare të Kosovës (mbi 8,500 përdorues të rinj në vitin 2022), kurse angazhimi i profesorëve prej UNKT-së gjatë vitit 2022 siguroi vitin e dytë të funksionimit të Programit të Ballkanistikës në Universitetin e Prishtinës, ku edukohen profesionistë të ardhshëm të gjuhës nga të gjitha komunitetet. Përpjekjet e përbashkëta të avokimit të komunitetit ndërkombëtar të udhëhequra nga UNKT-ja rezultuan në rivendosjen e Komisionit për Verifikimin e Diplomave në mesin e dhjetorit 2022, një hap kritik për sigurimin e qasjes në arsim dhe punësim për komunitetet jo-shumicë.

Edhe kohezioni social u forcua nga UNKT (duke përfshirë IOM, OHCHR dhe UNDP) përmes nxitjes së angazhimit të qytetarëve dhe ofrimit të mundësive për pajtim. Subjektet e OKB-së vazhduan të angazhohet në fushën e personave të pagjetur. Bashkëpunimi strategjik me Komisionin për Personat e Zhdukur në vitin 2022 rezultoi në përmirësimin e qeverisjes së brendshme. Mbështetja e ofruar për shoqatat e familjeve të personave të zhdukur synonte t’i bashkonte të dy komunitetet rreth një shqetësimi të përbashkët dhe të ofronte një rrugë për bashkëpunim të zgjeruar me mekanizmat institucionalë dhe partnerët ndërkombëtarë.

“Me pak fjalë shqip është e mundur të rrëzohen mosbesimi fillestar dhe pengesat e mundshme.”

Bibliotekarja serbe e Kosovës Ivana Stevanović mëson shqip përmes platformës VocUp të mbështetur nga IOM-i

Mbrojtja e objekteve kulturore dhe fetare dhe zakoneve dhe traditave jo-materiale që përfaqësojnë trashëgiminë e pasur multi-etnike të Kosovës, e mbështetur nga UNKT dhe me udhëheqje teknike nga UNDP, kontribuoi më tej në forcimin e besimit ndërmjet komuniteteve përmes punimeve të ruajtjes, kampeve restauruese multi-etnike, zhvillimit të shkathtësive dhe aktiviteteve promovuese. Në vitin 2022, njëmbëdhjetë lokacione në mbarë Kosovën u rehabilituan për përdorim nga komuniteti, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të rëndësishme; kurse dhjetë intervenime të tjera do të përfundojnë në vitin 2023. Kthimi i rëndësishëm dhe përdorimit prej komunitetit të monumenteve të rëndësishme si “Sahat Kulla” e shekullit të 19-të në zemër të Prishtinës, si dhe rehabilitimi i varrezave ortodokse dhe myslimane në Mitrovicë, tregojnë rolin e rëndësishëm që mund të luajë trashëgimia për ruajtjen e traditave të ndryshme dhe krijimin e krenarisë për një trashëgimi të përbashkët bashkuar. Këto efekte u forcuan përmes kampeve multi-etnike të restaurimit për studentët dhe me 10 vullnetarë të komunitetit të OKB-së, zhvillimit të shkathtësive të 350 pjesëmarrësve (90% gra; 50% komunitete jo-shumicë) për artizanatin dhe trashëgiminë kulturore jo-materiale, dhe vizitave studimore të më shumë se 300 pjesëmarrësve (40% gra dhe vajza; 15% komunitetet jo-shumicë). Më shumë se 140 pjesëmarrës (40% vajza; 85% komunitetet jo-shumicë) i rritën njohuritë e tyre për gjuhën dhe kulturën rome. Në Kosovën qendrore, përdorimi i trashëgimisë kulturore për të nxitur turizmin dhe zhvillimin socio-ekonomik, ka çuar në nisma për ringjalljen e Janjevës, një fshat me një histori të gjatë multi-etnike.

Shoqëria Civile merr përgjegjësinë: Vlerësimi i pavarur për të drejtave e njeriut hap rrugën për ndryshim

Zyra e OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (anëtare e UNKT-së dhe e integruar në Misionin e OKB-së në Kosovë) ka zhvilluar kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile për të monitoruar, analizuar dhe raportuar për shqetësimet e lidhura me të drejtat e njeriut në Kosovë. Në vitin 2022, Rrjeti për të Drejtat e Njeriut – një koalicion i organizatave bazë – mori një rol më të spikatur në monitorimin dhe analizimin e situatës në Kosovë. 37 organizata kanë përgatitur raportin e katërt për çështjet e të drejtave të njeriut, i vetmi raport i këtij lloji i udhëhequr nga organizatat kosovare.

Raporti propozon rekomandime për ndryshime legislative, rolin e institucioneve dhe praktikën më të mira institucionale për një gamë të gjerë të çështjeve të të drejtave të njeriut - ndalimi i torturës, të drejtat e personave dhe jeta, trajtimi njerëzor, liria, siguria e personit, gjykim i drejtë, mjetet efektive juridike, liria e shprehjes dhe mendimit, tubimi paqësor, liria e organizimit dhe liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo vëmendje ndaj shqetësimeve të lidhura me drejtat e njeriut ka çuar në refleksion publik dhe qeveritar për këto çështje. Duke plotësuar një hendek kritik në monitorim dhe raportim, kjo po i hap rrugën ndryshimeve në Kosovë, të nxitura nga vetë shoqëria civile dhe anëtarët e komunitetit.



“Ky raport plotëson një hendek kritik.”

Marigona Shabi
Drejtoreshë Ekzekutive, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Anëtare e Rrjetit për të Drejtat e Njeriut



Fusha Prioritare 5: Gjinia, fuqizimi dhe të dhënat

Kryesuar nga UN Women me UNFPA-në me pjesëmarrje nga IOM, OHCHR, UNDP, UN-Habitat, UNHCR, UNICEF



Në vitin 2022 u bënë përmirësime në lidhje me treguesit kyç të performancës për fuqizimin dhe ndryshimet e sjelljes, veçanërisht barazinë gjinore dhe përmbushjen e të drejtave themelore dhe përgjegjësi qytetare të bartësve të të drejtave. Përqindja e personave të moshës 15-49 vjeç që deklarojnë se dhuna në familje është e justifikuar është ulur nga 33% e grave dhe 15% e burrave në 25% të grave dhe 12% të burrave. Në mënyrë të ngjashme, numri i ankesave të paraqitura për dhunë në familje (OZHQ 5.2.1) u rrit për 21% (2,793 raste në 2022, nga 2,198 në 2019). Kjo mund të reflektojë rritje të raportimit, që do të ishte tregues i fuqizimit të shtuar dhe ndryshimeve pozitive të sjelljes në mesin e viktimave të dhunës në familje.

UNKT (duke përfshirë IOM, OHCHR, UNDP, UNFPA, UN-Habitat, UNHCR dhe UN Women) mbështeti shoqërinë civile dhe fuqizoi grupet e cenushme për pjesëmarrje më të mirë, për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të ushtruar përgjegjësinë qytetare. Organizatat e shoqërisë civile të Kosovës u mbështetën për të zbatuar projekte në favor të zbatimit të konkluzioneve të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventës së Stambollit, dhe instrumenteve të tjera për të drejtat e njeriut, duke përfshirë ato që synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave që kanë përjetuar diskriminim ose dhunë. Nëpërmjet intervenimeve të UNKT-së, adoleshentët dhe të rinjtë përfituan nga trajnimet për shkathtësitë për punë, jetë dhe angazhim qytetar, si dhe për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese. Përgjithësisht, rreth 15,000 adoleshentë dhe të rinj u pajisën me njohuri dhe aftësi avokuese për të adresuar nevojat dhe të drejtat e tyre, si dhe ato të komuniteteve të tyre dhe për të rritur angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes në komunitet.



Dhuna në familje konsiderohet më pak e pranueshme dhe raportohet më shpesh se më parë



15,000 të rinj të pajisur për avokim për nevojat e tyre dhe për t'u angazhuar në proceset vendimmarrëse në komunitet




60% e studentëve ndihen më të lirë për të biseduar rreth diskriminimit gjinor



Një studim i UNDP-së i dhjetorit 2022 për qëndrimet e të rinjve ndaj stereotipeve gjinore dhe normave sociale, thekson dallime të rëndësishme gjinore në qëndrime.

Qëndrimet e të rinjve ndaj Gjinisë dhe Normave Sociale Skano këtu



Për të rritur vetëdijësimin dhe njohuritë për dhunën në baza gjinore, rreth 300,000 persona u arritën përmes fushatës “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore”, me mbështetjen e UNKT-së dhe në partneritet me ndërmarrje publike, private, dhe shoqërinë civile. Me partnerët zbatues, gjatë vitit u organizuan pesë fushata të mëdha për vetëdijësim në rrjete sociale për politikën familjare me përgjegjshmëri gjinore dhe për Direktivën e BE-së për Ekuilibrin Punë-Jetë, duke arritur mbi 1.5 milion përshtypje. 1,038 migrantëve iu ofruan shërbime të drejtpërdrejta të OKB-së (procedurat e regjistrimit, përkthimi, strehimi, ushqimi, veshmbathja, kujdesi mjekësor dhe mbështetja psikosociale).

Si pjesë e përpjekjeve të monitorimit dhe raportimit, institucionet e Kosovës, me mbështetjen e UNKT-së (duke përfshirë IOM, UNDP, UNFPA, UNICEF, UN-Habitat dhe UN Women), po gjenerojnë gjithnjë e më shumë informata, dëshmi dhe të dhëna për vlerësimin e prioriteteve të Kosovës dhe zhvillimin e politikave, në përputhje me OZHQ-të. Në mbështetje të procesit të hartimit të Planit Kombëtar për Zhvillim 2030, nëpërmjet ekspertizës teknike agjencitë e OKB-së ofruan ekspertizë për të dhënat teknike për të ndihmuar në hartimin e një kornize gjithëpërfshirëse monitorimi, si dhe mbështetjen përfshirëse të rinjve nëpërmjet konsultimeve. Për më tepër, agjencitë e OKB-së vazhduan të përmirësojnë sistemin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve përmes mbështetjes teknike dhe financiare për Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe ministritë e linjës, me fokus në përmirësimin e proceseve të raportimit të të dhënave të fëmijëve dhe disponueshmërinë e të dhënave. Si rezultat, u ndërmorën hapat e parë për zhvillimin e një platforme për monitorimin e situatës së fëmijëve, e cila pritet të përfundojë në vitin 2023.

Me mbështetjen e UNKT-së, është përfunduar një vlerësim gjithëpërfshirës i sistemit të Regjistrimit Civil dhe Statistikave Jetësore të Kosovës, si dhe janë hartuar udhëzimet operative nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për mbledhjen e të dhënave relevante (informatat për lindjen, vdekjen dhe shkaqet e vdekjes, martesën dhe shkurorëzimin). Të dy dokumentet u validuan me palët e interesit dhe u nënshkrua një MM ndërmjet Agjencisë së Statistikave dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil; të dhënat e përforcuara për popullsinë dhe lëvizshmërinë janë jetike për llogaritjen e një game të gjerë të caqeve dhe treguesve të bazuar në popullsi të OZHQ-ve (OZHQ 16.9, 17.18, 17.19.2). UNKT identifikoi gjithashtu kontribuuesit kryesorë që shkaktojnë vetmi tek të moshuarit, dhe rekomandimet që rezultuan shërbyen për vlerësimin e një platforme avokimi për politikëbërjen dhe financimin e shërbimeve në mbështetje të të moshuarve.



Foto nga: ©UN-Habitat 2022

Mbështetje për partneritetet dhe financimi i Agjendës 2030

Për shkak të çështjeve të pazgjidhura të statusit, Kosova nuk përfiton nga fondet shumëpalëshe të OKB-së, siç janë mekanizmat financues të lidhur me Instrumentin Global për Mjedisin, Samiti për Sisteme Ushqimore ose Samiti për Transformim të Arsimit të OKB-së. Prandaj, statusi i Kosovës rrezikon të pengojë ambiciet globale për të mos lënë askënd pas. Megjithatë, në vitin 2022, Ekipi i OKB-së në Kosovë i konsolidoi dhe diversifikoi më tej partneritetet e veta për të ndihmuar në përshejtimin e arritjes së Agjendës 2030. U krijuan gjithashtu disa partneritete të reja inovative.

Partneritetet Institucionale

Bashkëpunimi me Zyrën e Planifikimit Strategjik të Kryeministrit dhe mbështetja e vazhdueshme e UNKT-së për Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kuvendit kontribuuan në integrimin e suksesshëm të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm jo vetëm në Planin Kombëtar për Zhvillim 2030 të qeverisë, por edhe në strategjitë kryesore sektoriale si Strategjia e Arsimit 2022-2026 dhe Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026. I rigjallëruar së fundmi me mbështetjen e UNKT-së, Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm do të ndihmojë në sigurimin e mbikëqyrjes së Planit Kombëtar për Zhvillim. Diskutimet me Kuvendin janë duke vazhduar për të zhvilluar një qendër të të dhënave për OZHQ-të dhe një Dashbord për OZHQ-të, të cilat, pasi të krijohen, do të shërbejnë për ta përcjellë më mirë progresin e Kosovës drejt arritjes së OZHQ-ve. Gjithashtu, u funksionalizua Këshilli për Ndryshime Klimatike me synimin për t'i ndihmuar Kosovës që të nisë rrugëtimin e saj për të reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe për të rritur burimet e ripërtërishe të energjisë.

Si rezultat i avokimit për prioritetet kyçe të OZHQ-ve, qeveria mori disa vendime kyçe për ndarjen e buxhetit, të tilla si rritja për 5.8 milionë euro e shpenzimeve për edukimin e hershëm për vitin 2023. Kosova Generation Unlimited, platformë madhore e partneritetit publik-privat për shkathtësitë dhe punësueshmërinë e të rinjve, dëshmoi rritje të madhe në vitin 2022, me një model të ri zbatimi të funksionalizuar nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për rritje të shkallës dhe bashkë-financim të praktikave me pagesë, mentorimeve dhe trajnimeve për 10,000 të rinj gjatë dy viteve të ardhshme, si dhe për kontribuar pozitivisht në reduktimin e të rinjve NEET (OZHQ 8.6.1) në Kosovë. Me mbështetjen e UNKT-së, në korrik 2022, Vushtrria u bë komuna e parë në Kosovë që prezantoi një shqyrtim vullnetar lokal të zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, bazuar në informacionin e mbledhur nga banorët në lidhje me nevojat dhe sfidat sociale, mjedisore dhe ekonomike.

Partneritete jo tradicionale

Rrugë të reja për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm u hapën përmes bashkëpunimit të ngushtë me Manifesta 14, festivali Bienal Evropian Nomad i artit bashkëkohor, i cili synon të sigurojë një platformë dinamike për shkëmbimin kulturor në Evropë. Mes korrikut dhe tetorit, me mbështetjen e UNKT-së, pjesë të linjës së ndërprerë hekurudhore Prishtinë-Beograd u hapën si instalim i korridorit të gjelbër prej 1,300 metrash, si përfaqësim vizual i lidhjes së komuniteteve përmes një përdorimi më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës të hapësirës publike. Transformimi i një biblioteke publike të braktisur në Prishtinë në Qendër për Praktikë Narrative siguroi një hapësirë ndërdisiplinore për qytetarët nga të gjitha komunitetet. Hapësira është e hapur dhe e lirë për t'u përdorur nga persona kreativë nga fusha të ndryshme kulturore dhe akademike, si një hapësirë për bashkëpunim dhe takime, ndërsa organizatat mund ta përdorin hapësirën për eventet dhe tubimet e tyre. UNKT-ja mbështeti edhe Bienalen Autostrada dhe festivalin ndërkombëtar të filmit dokumentar dhe të shkurtër Dokufest në Prizren.

Së bashku me Federatën e Futbollit të Kosovës, komunën e Prishtinës, Fondacionin e UEFA-s, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Presidenten Osmani, mbështetja e UNKT-së për klubin multi-etnik të futbollit të vajzave "KFV Prishtina" promovoi fuqizimin e vajzave, shëndetin fizik dhe mirëqenien emocionale, si dhe zhvillimin social. Për katër vite, pjesëmarrja e grave dhe vajzave të reja nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë është rritur për 300%. Numri i gjyqtareve gra të certifikuar u rrit nga 8 në 20.



Avokimi përmes promovimit dhe kreutimit të "Ditëve Ndërkombëtare" dhe fushatave ndërkombëtare dhe lokale

Ekipi i OKB-së në Kosovë organizoi fushata dhe nisma duke bashkuar partnerët anëmbanë Kosovës në kreutimin e ditëve të posaçme. Përmes bashkëpunimit me aktiviste dhe lidere për të drejtat e grave në Kosovë, Misionin e OKB-së në Kosovë dhe UNKT-në, Dita Globale e Hapur 2022 u ofroi grave një platformë për t'u dëgjuar nën temën, "Thyerja e Barrierave dhe Ndërtimi i Paqes: Avancimi i pjesëmarrjes së grave në proceset politike." Në tetor, 20 të rinj me Sindromën Down festuan Ditën e OKB-së së bashku me anëtarët e UNKT-së dhe UNMIK-ut, duke theksuar rëndësinë e diversitetit dhe përfshirjes. Fushata 16-ditore e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore, e organizuar nga Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e UNKT-së, përfshiu gjithsej 120 evente në mbarë Kosovën në vitin 2022. Forumi i nivelit të lartë i tetorit për Gratë për Paqen dhe Sigurinë i iniciuar nga presidentja Osmani me mbështetjen e UNKT-së, mblodhi më shumë se 500 pjesëmarrës nga 36 vende dhe gjeneroi mbi 5 milionë angazhime në rrjete sociale. Ai ngriti vetëdijesimin për kontributin e rëndësishëm të dhënë nga gratë dhe vajzat në proceset e paqes dhe sigurisë. Me qëllim të përmirësimit të qasjes në informacion, UNKT gjithashtu mbështeti Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës për të ndarë çmimin për gazetari kundër korrupsionit për vitin 2022.









"Asnjë proces paqeje nuk mund të jetë i suksesshëm kur gjysma e shoqërisë lihet pas."
Presidente Vjosa Osmani



Partneritetet me Sektorin Privat

Partneritetet me sektorin privat rezultuan në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë dhe PricewaterhouseCoopers që iu bashkuar komunitetit të mbi 7,000 bizneseve anëmbanë globit si dy nënshkruese të reja të Parimeve të Fuqizimit të Grave. Shtatë kompani të sektorit privat po ndryshojnë politikat dhe praktikatat e tyre të brendshme për t'u bërë vende pune më miqësore për familjen, duke ofruar kushte dhe përfitime më të mira pune për 656 punonjësit e tyre, çka pritet të kontribuojë në uljen e hendekut gjinor. Njëpërmjet partneriteteve me Raiffeisen Bank, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Aeroportin Ndërkombëtar Limak, është mbështetur zhvillimi i shkathtësive dhe fuqizimi i të rinjve, duke rritur përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, promovimin e zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe fuqizimin e vajzave dhe grave të Kosovës në STEM/inxhinieri. Qendra e Inovacionit në Kosovë mbështeti BOOST x Kosovo dhe, përmes tij, zgjodhi 50 ndërmarrje të vogla dhe të mesme për të marrë pjesë në një program përshejtimes, me potencial për t'i ofruar Kosovës zgjidhje inovative drejt tranzicionit të gjelbër dhe qëndrueshmërisë.

Rezultatet kyçe të Partneriteteve Inovative dhe Përpjekjeve Avokuese

-  10,000 praktika me pagesë të siguruar për Kosovo Generation Unlimited 2023-2024
-  Mobilizimi i alokimit buxhetor prej 5.8 milion eurosh për arsimin në fëmijëri të hershme
-  7 kompani të sektorit privat që promovojnë kushte pune miqësore me familjen për 656 punonjës
-  I pari shqyrtim vullnetar lokal në Kosovës tregon si munden komunitat ta përcjellin përparimin e OZHQ-ve në nivel lokal
-  Qendra për Praktikën Narrative në Prishtinë ofron hapësirë të takimi për të gjitha komunitetet
-  Numri i grave dhe vajzave të reja që luajnë futboll është trefishuar në katër vjet

Rezultatet e punës së përbashkët të OKB-së: Koherenca, Efektshmëria dhe Efikasiteti i OKB-së

Në vitin 2022, duke synuar përgjigje efektive, Koordinatorja për Zhvillim e OKB-së lehtësoi bashkëpunimin për shtylla të ndërthurura ndërmjet agjencive rezidente dhe jo-rezidente. Zbatimi i Kornizës së Bashkëpunimit u siguroi nga Grupet e Rezultateve të bashkë-kryesura nga Udhëheqësit e Agjencive të OKB-së, duke siguruar zhdërvjelltësi, përafrim me prioritetet e qeverisë, si dhe aftësinë për t'iu përgjigjur nevojave në zhvillim. Komiteti i Përbashkët Drejtues, i bashkë-kryesuar nga Koordinatorja për Zhvillim e OKB-së dhe Kryeministri, dhe i përbërë nga ministra dhe udhëheqësit e UNKT-së, vazhdoi të ofrojë drejtim, mbikëqyrje, monitorim dhe shqyrtim të progresit të përgjithshëm, ndërsa grupet e tjera tematike për të drejtat e njeriut, migracionin dhe të rinjtë u galvanizuan për të mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve, barazinë gjinore dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për kthime. Ekipi i OKB-së në Kosovë zbatoi Planin e Veprimit të Sistemit të OKB-së për barazinë gjinore, duke i përmbushur ose tejkaluar kërkesat minimale për të gjithë 15 treguesit e performancës, dhe u rendit globalisht në mesin e ekipeve vendore me performancën më të mirë të OKB-së si pjesë e raportit të progresit Rinia 2030. Grupi Koordinues për parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual ngriti në mënyrë proaktive vetëdijësimin për të nxitur një kulturë të tolerancës zero dhe kapacitete të zgjeruara të personelit të OKB-së. Është shqyrtuar Strategjia e OKB-së për Punët Operacionale për t'iu siguruar që programet e Kombeve të Bashkuara të jenë me kosto efektive dhe efikase, dhe me ndikim. Gjatë vitit, përmes aktiviteteve të përbashkëta operacionale u kursyen 50,239 dollarë. Portali i të dhënave UN-INFO vazhdoi të ofrojë një hapësirë ku donatorët mund të lexojnë për progresin e zhvillimit të UNKT-së dhe kontributet e donatorëve. Ueb faqja e UNKT tani është e disponueshme në tri gjuhë, duke i bërë mesazhet dhe pikat kryesore të aktivitetit të OKB-së të qasshme për të gjitha komunitetet, dhe kjo ka sjellë pothuajse 9,000 përdorues të rinj dhe 20,000 kërkime që nga prezantimi i ueb faqes së re. Me 84% të qytetarëve në Kosovë që nuk kanë dëgjuar kurrë për OZHQ-të (Pulsi Publik 23, nëntor 2022), ueb faqja ofron një mekanizëm të rëndësishëm për avokim.

Përmes programit të përbashkët për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (duke përfshirë ILO dhe UN Women), UNKT-ja ka punuar me institucionet e, botën akademike, shoqërinë civile dhe gratë ndërmarrëse për të rritur njohuritë dhe shkathtësitë e në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Është ngritur vetëdijësimi për parandalimin

në sport tek komuniteti sportiv, donatorët dhe partnerët, në partneritet me Komitetin Olimpik të Kosovës. UNKT-ja (duke përfshirë UNDP-në, UNFPA-në dhe UN Women) mori pjesë në një projekt inovativ rajonal, Të rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim, duke rritur vetëdijësimin për të drejtat e njeriut dhe u ofron mësimdhënësve dhe të rinjve metodologji të ndërhyrjes nga kalimtarët për të ndihmuar në adresimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.

Në lidhje me mbrojtjen sociale, natyra e përbashkët e punës së UNKT-së ishte evidente në mbështetje të sistemit shëndetësor të përforcuar, ku bashkëpunimi midis UNFPA-së, UNICEF-it, UNOPS-it dhe OBSH-së çoi në një plan strategjik për gatishmëri dhe reagim për të menaxhuar goditjet, një draft plan për mbulimin universal shëndetësor, një protokoll për menaxhimin e mbetjeve të kujdesit shëndetësor, një sistem operacional me zinxhir të ftohtë për vakcina, profesionistë të trajnuar të kujdesit shëndetësor, dhe ofrimin e shërbimeve të vizitave në shtëpi për komunitetet në risk. Përpjekjet në favor të zhvillimit ekonomik janë parë si në avancimet në edukim ashtu edhe në punësim. Theksi i përbashkët nga ILO, UNFPA, UNICEF dhe UNOPS për përmirësimin e sistemeve dhe infrastrukturës arsimore që përkon me përpjekjet e ILO-s, IOM-it, UNDP-së, UN-Habitat-it, UNICEF-it dhe UN Women për të reduktuar risqet e braktisjes së shkollës (p.sh. puna e fëmijëve, ndikimet e pandemisë, mungesa e qasjes në shërbimet e nevojshme sociale, migrantët e cenueshëm të lënë pas) rezultuan në një kornizë politike dhe legjislative për edukimin në fëmijëri të hershme, rritjen e kapaciteteve mes mësimdhënësve të shkollave fillore, duke përfshirë në favor të mësimdhënies gjithëpërfshirëse, qasjen e mbështetur në edukim për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe zhvillimin e një kornizë monitorimi dhe vlerësimi për edukimin seksual. Qasja në punë të denjë u lehtësua nga ILO, UNFPA dhe UN Women nëpërmjet avokimit për politikën familjare me përgjegjshmëri gjinore, si dhe përmes mbështetjes teknike për zhvillimin e një projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së. Agjencitë, duke përfshirë ILO, IOM, UNDP, UNICEF dhe UN Women, bashkuan forcat për forcimin e mundësive ekonomike për më të cenueshmit, duke përfshirë përmes këshillave teknike për Agjencinë e Punësimit të republikës së Kosovës dhe portalin Kosovo Job, përmes ndërtimit të aktiviteteve që gjenerojnë të hyra, programimit të punësimit, mbështetjes së ndërmarrjeve mikro/të vogla dhe ofrimit të mundësive për trajnim dhe praktikë.



Në mënyrë të ngjashme, përpjekjet në favor të ndërtimit të paqes dhe kohezionit social mblodhën së bashku IOM-in, UNDP-në, UNFPA-në, UNICEF-in dhe UN Women, për të mbështetur aktivitetet që bashkojnë qytetarët, rrisin vetëdijësimin dhe nxisin përfshirjen, si mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, projektet ndëretnike në komunitet, mësimi i gjuhës. Në të njëjtën kohë, përpjekjet e IOM-it, UNDP-së, UNFPA-së dhe UN Women rezultuan në angazhimin e të rinjve për të udhëhequr përpjekjet për ndërtimin e paqes, iniciativat për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe programet për ndërhyrje të kalimtarëve për të trajtuar narrativat përçarëse dhe për të mbështetur dialogun ndërkulturor. U bënë përpjekje të përbashkëta nga FAO, UNDP, UN-Habitat dhe OBSH në favor të veprimit për klimën. Kapacitetet lokale, planet lokale të veprimit për klimën, sistemi i menaxhimit të mbetjeve dhe angazhimi qytetar në veprimin lokal për klimën, u forcuan nga UNDP-ja. FAO, UNDP dhe OBSH i përforcuan këto masa duke punuar për uljen e ndotjes së ajrit dhe ndikimeve shëndetësore të lidhura me klimën, si dhe për përmirësimin e ekosistemit pyjor dhe mbjelljen e drunjve. Në secilën fushë prioritare, mesazhet e vazhdueshme dhe avokimi i koordinuar në favor të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave ishte i dukshëm në ndryshimet pas avokimit dhe mbështetjes së ofruar nga OHCHR, UNHCR, UNICEF dhe UN Women, për zbatimin e monitorimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe raportimit, zhvillimin e buxhetit me përgjegjshmëri gjinore, politikën familjare me përgjegjshmëri gjinore dhe mjediset miqësore me familjen në vendin e punës në kompanitë e sektorit privat.

Përmes angazhimeve të përbashkëta për kohezionin social dhe ndërtimin e paqes, të rinjtë që sjellin ndryshime, gratë, paqen dhe sigurinë, të drejtat e njeriut, si dhe përmes diversitetit dhe përfshirjes u demonstrua përkushtimi i OKB-së për të bashkuar përpjekjet humanitare, zhvillimore dhe për ndërtim të paqes të ilustruara në qasjet e përbashkëta ndaj Ditës së Hapur Globale, Asamblesë Rinore të OKB-së dhe Ditës së OKB-së.

Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Bankën Botërore në një numër të sektorëve kyç, Ekipi i OKB-së në Kosovë ishte në gjendje të krijonte sinergji dhe të përfitonte nga ekspertiza dhe burimet e IFN-ve.



Agjenda digjitale



Edukimi/Zhvillimi në Fëmijëri të Hershme



Mjedisi



Shëndeti, duke përfshirë reagimin ndaj COVID



Mbrojtja sociale



Transporti



Pasqyrë e përgjithshme financiare dhe e mobilizimit të resurseve


Në vitin 2022, viti i dytë i zbatimit të Kornizës së Bashkëpunimit në Kosovë, janë siguruar resurse të disponueshme prej 43.4 milionë dollarësh. Kjo shumë përbën një rritje të konsiderueshme nga nivelet vjetore të resurseve të përbashkëta para pandemisë prej rreth 20 milionë dollarësh. Shpenzimet totale për vitin 2022 ishin 35.4 milionë dollarë, duke reflektuar një shkallë ofrimi prej 82% në pesë fushat prioritare të Kornizës së Bashkëpunimit.

Fusha prioritare 2 "Shërbime dhe politika sociale gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese" ka qenë e financuar me rreth 52% të buxhetit të përgjithshëm, e pasuar nga fusha prioritare 3 "Zhvillim ekonomik rezistentë, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës" me mbi 22% dhe fusha prioritare 4 "Kohezioni social" me 13%.


Buxheti i përgjithshëm i disponueshëm dhe niveli i shpenzimeve në vitin 2022

Fusha prioritare të OKB-së	Buxheti i disponueshëm	Shpenzimet	Shkalla e realizimit
1. Qeverisja Llogaridhënëse	\$ 3,977,756	\$ 3,229,703	81%
2. Politika dhe Shërbime Sociale	\$ 22,545,107	\$ 18,857,707	84%
3. Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik	\$ 9,529,949	\$ 7,543,586	79%
4. Kohezioni Social	\$ 5,471,718	\$ 4,080,921	75%
5. Gjinia, Fuqizimi dhe të Dhënat	\$ 1,898,853	\$ 1,728,574	91%
Buxheti total:	\$ 43,423,383	\$ 35,440,491	82%


Burimet e fondeve ishin kontributet nga donatorët dypalësh dhe donatorë të tjerë, ndarja e kostove me qeverinë e Kosovës dhe financimi bazë i UNKT-së ose financim tjetër i OKB-së. Pjesëmarrja në disa programe rajonale (Fondi për Ndërtimin e Paqes, programet rajonale të UN Women dhe UNDP-së) i dha UNKT-së qasje në financimin rajonal për mbështetjen e prioriteteve lokale. Falënderojmë kontribuuesit e shteteve anëtare në nivel global.



Donatorë dypalësh dhe të tjerë



Qeveria e Kosovës



Financimi i OKB-së


Zbërthimi i fondeve të vitit 2022 sipas Agjencie të OKB-së

Agjencia e OKB-së	Gjithsej buxheti i disponueshëm	Gjithsej shpenzime	Shkalla e realizimit
FAO	\$ 825,000	\$ 750,000	91%
ILO	\$ 362,500	\$ 362,500	100%
IOM	\$ 9,463,045	\$ 5,656,255	60%
OHCHR	\$ 387,253	\$ 387,253	100%
UN-Habitat	\$ 1,644,350	\$ 1,420,180	86%
UNDP	\$ 14,646,976	\$ 11,887,822	81%
UNFPA	\$ 910,760	\$ 870,010	96%
UNHCR	\$ 350,712	\$ 336,515	96%
UNICEF	\$ 6,927,677	\$ 6,713,521	97%
UNOPS	\$ 5,809,130	\$ 5,316,606	92%
UN Women	\$ 736,100	\$ 700,616	93%
WHO	\$ 1,359,880	\$ 1,039,213	76%
Total	\$ 43,423,383	\$ 35,440,491	82%


Partnerët dhe donatorët kontribues në vitin 2022

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, totali i donacioneve të marra nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara tejkaloi 43.4 milionë dollarë. BE-ja, përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit dhe financimeve të tjera, kontribuoi më shumë se 10.6 milionë dollarë, e ndjekur nga afër nga qeveria e Kosovës me më shumë se 10.3 milionë dollarë. Kontribues të tjerë kyçë ishin qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Suedisë dhe Luksemburgut.

5 Partnerët Kontribues Kryesorë



Alokimi i fondeve sipas OZHQ-ve dhe caqeve



Kapitulli 3:
**Fokusi kyç i Ekipit të Kombeve të Bashkuara
në Kosovën për vitin 2023**



Korniza e Bashkëpunimit

Në vitin 2023, Korniza e Bashkëpunimit do të jetë në vitin e tretë të zbatimit dhe do të mbetet udhërrëfyesi kryesor i Ekipit të OKB-së në Kosovë që na drejton drejt arritjes së qëllimeve zhvillimore të Kosovës dhe OZHQ-ve. Nëpërmjet saj, ne do të priorizojmë kohezionin social, drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin, me theks të veçantë në rolin e grave dhe të rinjve. Ndikimet e proceseve të anëtarësimit në BE merren parasysh në të gjitha angazhimet e OKB-së. Korniza evoluon për t'iu përshtatur konteksteve në ndryshim, si lufta në Ukrainë, inflacioni dhe nevojat e qeverisë.


Duke punuar me qeverinë, BE-në dhe partnerë të tjerë, UNKT do të veprojë brenda gjashtë fushave hyrëse të identifikuara në Raportin Global të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2023 përkatësisht arsimit, sistemet ushqimore, energjia, transformimi digjital, klima dhe mjedisi, vendet e punës dhe mbrojtja sociale - duke pasur si synim përshtetimin e progresit të Kosovës drejt OZHQ-ve deri në vitin 2030.

Gjashtë transformime për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Fushat ndërsektoriale:
Rinia, Barazia Gjinore, Fuqizimi i Grave dhe të Drejtat e Njeriut

Vendet e Punës dhe Mbrojtja Sociale

Klima dhe Mjedisi



Gjatë vitit të ardhshëm, OKB do ta mbështesë qeverinë e Kosovës në fushat kyçe, të cilat mund të veprojnë si përsheptues të OZHQ-ve dhe të ndihmojnë për ndryshime transformuese. Kjo përfshin ndihmën në zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillim 2030, së bashku me strategjitë sektoriale për arsimin dhe energjinë. Transformimi digjital do të përmirësojë komunikimin dhe qasjen në shërbimet sociale.

Ne do t'i avancojmë përpjekjet tona programore në fushat prioritare, duke theksuar kohezionin social, drejtësinë dhe pajtimin. Ne do të priorizojmë reformën e mbrojtjes sociale për të siguruar që ndihma dhe mbështetja t'i targetojnë më mirë dhe t'u shërbejë personave në risk më të madh që të mbeten pas, dhe që sistemi të jetë në gjendje të trajtojë varfërinë dhe të reagojë në mënyrë efektive ndaj goditjeve. Do të mbështetet angazhimi, arsimimi dhe punësimi i të rinjve, në përputhje me Garancinë e BE-së për Rininë, strategjinë e qeverisë për ulje të papunësisë së të rinjve, dhe strategjisë së re të qeverisë për Rininë. Reformat e sektorit të banimit, përmes hartimit të Ligjit të ri për banim social, do të mbështeten në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve nga Studimi i Fizibilitetit për Banim Adekuat Social për Kosovën, i mbështetur nga UNKT-ja.

Si përgjigje ndaj ngrohjes së klimës, ne do të ndihmojmë tranzicionin e gjelbër të Kosovës, do të forcojmë ekonominë qarkore, do të përmirësojmë veprimin për klimën dhe do të përmirësojmë menaxhimin e mbetjeve në kujdesin shëndetësor. Pas vërshimeve në fillim të vitit 2023, ne do të vazhdojmë zbatimin e Planit të UNKT-së për Reagim ndaj Vërshimeve dhe Rimëkëmbje të Hershme, veçanërisht për amvisëritë e cenueshme, dhe do të shfrytëzojmë mundësinë për ta forcurar më tej lidhjen ndërmjet çështjeve humanitare, zhvillimore, dhe të paqes. Për t'i identifikuar dhe ndihmuar më mirë grupet e marginalizuara, ne do të mbështesim qeverinë në kryerjen e regjistrimit të parë të popullsisë dhe ekonomive familjare që nga viti 2011, si dhe për të zhvilluar të dhëna të zbërthyera. Kjo do të informojë vendimmarrjen, planifikimin e zhvillimit, monitorimin e progresit të OZHQ-ve, shpërndarjen e infrastrukturës, planifikimin e zgjedhjeve dhe analizën e tregut. Regjistrimi gjithashtu do të promovojë barazinë gjinore dhe do të mbështesë buxhetimin me përgjegjshmëri gjinore.



Agjenda jonë e përbashkët Skano këtu

Të udhëhequr nga Agjenda jonë e përbashkët, vizioni i Sekretarit të Përgjithshëm për të ardhmen e bashkëpunimit global, ne do të mbrojmë multilateralizmin për të arritur synimet e përbashkëta, duke mbështetur qeverinë e Kosovës për të arritur objektivat e veta, si dhe duke bashkëpunuar

nga afër me donatorët, akterët zhvillimorë, shoqërinë civile dhe vetë anëtarët e komunitetit, për të identifikuar fushat e nevojave dhe strategjitë për t'i adresuar ato në mënyrë bashkëpunuese. Ne do të bashkëpunojmë me qeverinë për të mobilizuar resurset e donatorëve, për të përmirësuar koordinimin e donatorëve, si dhe do të përipiqemi të lehtësojmë pjesëmarrjen e Kosovës në forume shumëpalëshe dhe samite globale. Partneritetet ekzistuese, si p.sh. me BE-në, do të forcohen, ndërkohë që do të krijohen marrëdhënie të reja për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Koordinatorja për Zhvillim e OKB-së do të mobilizojë ekspertizën e gjerë të OKB-së dhe mandatet unike të agjencive rezidente dhe jo-rezidente për të krijuar sinergji në favor të një qasje bashkëpunuese që përfshin programim dhe avokim të përbashkët, së bashku me partneritetin e bashkuar me qeverinë.

Parimi “të mos lëmë askënd pas”, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore do të jenë thelbi i përpjekjeve të OKB-së për avokim. Ato do të integrohen në strategjitë dhe politikat e Kosovës dhe mbledhja e të dhënave do të zbërthehet sipas gjinisë dhe diversitetit. OKB do të theksojë pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara dhe do të zbatojë programe për të siguruar qasjen e tyre në të drejta.

Plani Kombëtar për Zhvillim i miratuar së fundi, i lidhur ngushtë me aspiratat e Kosovës për integrim evropian, si dhe me Kornizën e Bashkëpunimit të UNKT-së, Agjendën 2030 dhe OZHQ-të, ofron një shans të ri për katalizimin e flukseve financiare publike dhe private drejt thjeshtimit të financimit për objektiva afatgjata që mbështesin zgjidhjet e reja zhvillimore dhe politika dhe vendimmarrje më të targetuar.

Parimi “të mos lëmë askënd pas”, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore do të jenë thelbi i përpjekjeve të OKB-së për avokim.

ANEKS:
Përcjellja e progresit të Kornizës së Bashkëpunimit



Rezultati 1: Deri në vitin 2025, të gjithë qytetarëve të Kosovës, gra dhe burra, u shërbejnë institucione më llogaridhënëse, efektive, transparente dhe me përgjegjshmëri gjinore në të gjitha nivelet, duke siguruar qasje në drejtësi, barazi dhe pjesëmarrje për të gjithë

Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Perceptimi i qytetarëve për kënaqshmërinë me punën e institucioneve të Kosovës (UNDP) – OZHQ 16.6.2	Gjithsej: 22% (2019) Burra: 18,6% Gra: 20,7% Shqiptarë të Kosovës: 17,8% Serbë të Kosovës: 3,2% Të tjerë në Kosovë: 20,9%	Gjithsej: 25% (2025) Burra: 21% Gra: 24% Shqiptarë të Kosovës: 21% Serbë të Kosovës: 7% Të tjerë në Kosovë: 24%	Gjithsej: 51,4% (2021) Burra: 60,4% Gra: 61,1% Shqiptarë të Kosovës: 62,7% Serbë të Kosovës: 3% Të tjerë në Kosovë: 61,5%	Gjithsej: 45,93% (2022) Burra: 45,2% Gra: 47% Shqiptarë të Kosovës: 46,8% Serbë të Kosovës: 14,2% Të tjerë në Kosovë: 64%	↗
Perceptimi i qytetarëve që besojnë se vendimmarrja në institucionet e Kosovës është gjithëpërfshirëse dhe përgjegjëse (UNDP) – OZHQ 16.7.2	Gjithsej: 6,75% (2019) Burra: 5,95% Gra: 7,55% Shqiptarë të Kosovës: 6% Serbë të Kosovës: 20,7% Të tjerë në Kosovë: 6,2%	Gjithsej: Më shumë se niveli bazë	Gjithsej: 20,1% Burra: 20,2% Gra: 19,8% Shqiptarë të Kosovës: 18,8% Serbë të Kosovës: 19,1% Të tjerë në Kosovë: 21,9%	Gjithsej: 22,55% Burra: 22,4% Gra: 22,9% Shqiptarë të Kosovës: 22,8% Serbë të Kosovës: 22,2% Të tjerë në Kosovë: 15,5%	↗
Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike (UN-Habitat dhe agjenci të tjera të përfshira) – OZHQ 11.3.2	Gjithsej: 53,79% (2019) Gra: 47,11% (2019)	Gjithsej: 65% Gra 60%	Gjithsej: 21,91% Gra: 29,01%	Të dhënat priten në maj 2023	↘
Vlera e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (UNDP) – OZHQ 16.5.1	36 (2019)	45	39	41	↗
Vlera e aseteve kriminale të ngrira, te sekuestruara dhe të konfiskuara (UNODC) – OZHQ 16.4	Vlera e aseteve të ngrira (2019): € 3,358,030.25 Vlera e aseteve të sekuestruara (2019): € 429,277.38 Vlera e aseteve të konfiskuara (2019): € 991,593.51	Rritja e vlerës së aseteve (të ngrira, të sekuestruara dhe të konfiskuara)	Vlera e aseteve të konfiskuara: 5,210,528.20	Vlera e aseteve kriminale të ngrira, te sekuestruara dhe të konfiskuara: € 21,398,730,56 Vlera e aseteve të konfiskuara: € 669,756.14	↗
Numri i personave (të cenueshëm) /rasteve që përfitojnë nga qasja në drejtësi (UNHCR, UNDP, IOM) – OZHQ 16.3	650 (Gra: 319) të mbështetur nga OSHC-të dhe 5,539 raste të trajtuara nga Agjencia e Ndhmës Juridike Falas	3,000 (Gra: 1,225) të mbështetur nga OSHC-të 6,500 raste të trajtuara nga Agjencia e Ndhmës Juridike Falas	200 raste (UNDP) 280 (UNHCCR)	200 raste (UNDP) 245 (UNHCR)	↘
Përqindja e rekomandimeve të lëshuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të zbatuara nga autoritetet e Kosovës (OHCHR)	34% (2019)	50%	37%	22.90%	↘



Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Përqindja e grave në pozita vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal (UN Women) – OZHQ 5.5.1	<p>31,2% (zgjedhjet e përgjithshme 2019)</p> <p>36% (zgjedhjet komunale 2017)</p> <p>33,3% ministre gra (zgjedhjet e përgjithshme 2019)</p> <p>0% gra kryetare komune (zgjedhjet komunale 2017)</p>	<p>40% zgjedhje të përgjithshme</p> <p>40% zgjedhje komunale</p> <p>40% gra ministre</p> <p>10% gra kryetare komune</p>	<p>25% zgjedhjet e përgjithshme 2020</p> <p>37% gra deputete</p> <p>33% ministre gra - Zgjedhjet komunale 2021</p> <p>0% gra kryetare komune</p> <p>1,14% gra nënkryetare komune</p> <p>33% përfaqësimi i grave në kuvendet komunale</p>	Asnjë ndryshim	—
Përqindja e qytetarëve që ndihen të sigurt dhe me siguri (UNDP) –OZHQ 16.1.4	<p>Gjithsej: 75,60% (2019)</p> <p>Burra: 71,4%</p> <p>Gra: 72,90%</p> <p>Shqiptarë të Kosovës: 71%</p> <p>Serbë të Kosovës: 21,65%</p> <p>Të tjerë në Kosovë: 58%</p>	<p>Gjithsej: 85%</p> <p>Burra: 80%</p> <p>Gra: 77%</p> <p>Më shumë se niveli bazë</p>	<p>Gjithsej: 76,4 %</p> <p>Burra: 76%</p> <p>Gra: 76,7%</p> <p>Shqiptarë të Kosovës: 76,4%</p> <p>Serbë të Kosovës: 34,8%</p> <p>Të tjerë në Kosovë: 85%</p>	<p>Gjithsej: 80,43%</p> <p>Burra: 81,1%</p> <p>Gra: 79,8%</p> <p>Shqiptarë të Kosovës: 83,3%</p> <p>Serbë të Kosovës: 15,3%</p> <p>Të tjerë në Kosovë: 79,5%</p>	↗
Ekzistenca e sistemeve funksionale që i gjurmojnë dhe bëjnë alokime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave (UN Women) OZHQ 5.c.1	Nuk është vendosur	Sistemi i vendosur për të gjurmuar në nivel qendror dhe komunal	Nuk është vendosur	Nuk është vendosur	ND



Rezultati 2: Deri në vitin 2025, të gjitha vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, veçanërisht më të margjinalizuarit, gëzojnë qasje të përmirësuar dhe përdorin mbrojtje sociale të barabartë, cilësore dhe të integruar, si dhe shërbime shëndetësore universale dhe arsim cilësor

Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Mbulimi i shërbimeve thelbësore shëndetësore (Mbulimi Universal Shëndetësor) – OZHQ 3.8.1	70% e MUSH-it i siguruar (2019)	85% e MUSH-it	70%	100%	↗
Qasje në shërbime esenciale cilësore të kujdesit shëndetësor veçanërisht për sëmundjet jo ngjitëse (SJNI) (OBSH)	Nuk ka asnjë vlerësim për cilësinë e shërbimeve shëndetësore, përfshirë edhe për SJNI	Të përcaktohet pasi të bëhet vlerësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore	Anketa STEPS e kryer	Anketa STEPS e përfunduar	↗
Përqindja e emergjencave shëndetësore që zbulohen dhe trajtohen me shpejtësi (OBSH) – OZHQ 3.d	85% e të gjitha ngjarjeve emergjente zbulohen dhe trajtohen në kohë (2019)	95% e të gjitha ngjarjeve emergjente zbulohen dhe trajtohen në kohë	100%	100%	↗
Niveli i qasjes në barna dhe vaksina esenciale të sigurta, cilësore dhe të përballueshme (UNICEF/UNFPA/WHO) – OZHQ 3.b.1 dhe OZHQ 3.b.3	<p>Përqindja e fëmijëve nën 1 vjeç që marrin vaksinën DPT3:</p> <p>95% (Djem: 95% Vajza: 95% Romë, Ashkali dhe Egjiptas 63%) (2020)</p> <p>1 lloj i kontraktivëve modernë të blerë përmes Listës së Barnave Esenciale (2019)</p>	<p>98% (Djem: 98% Vajza: 98% Romë, Ashkali dhe Egjiptas: 80%)</p> <p>3 lloje të kontraktivëve modernë të blerë përmes Listës së Barnave Esenciale</p>	<p>90% popullata e përgjithshme</p> <p>57% komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas)</p> <p>0 lloje të kontraktivëve modernë</p>	<p>90% popullata e përgjithshme</p> <p>57% komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas)</p> <p>3 lloje të kontraktivëve modernë të blerë përmes Listës së Barnave Esenciale</p>	—
Përqindja e fëmijëve 0-5 muajsh që ushqehen ekskluzivisht me gji (UNICEF)	Gjithsej: 40% Urban: 50% Rural: 34% (2020)	Gjithsej: 55% Urban: 65% Rural: 53%	Gjithsej: 29% Urban: 33,4% Rural: 27,4%	Gjithsej: 29% Urban: 33,4% Rural: 27,4%	↘
Numri i institucioneve shëndetësore që ofrojnë shërbime të skringut të kancerit të qafës së mitrës dhe zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit (UNFPA)	5 (2019)	15 (2025)	6	6	↗
Përqindja e fëmijëve (36–59 muaj) që ndjekin një program edukimi në fëmijërinë e hershme (UNICEF) – OZHQ 4.2.2	Gjithsej: 14% Vajza: 14% Djem: 14%	Gjithsej: 50% Vajza: 50% Djem: 50%	Gjithsej: 15% Vajza: 13,4% Djem: 16,6%	Gjithsej: 15% Vajza: 13,4% Djem: 16,6%	↗



Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Nxënësit që arrijnë të paktën një nivel minimal të zotësisë në lëndët themelore (UNICEF) – OZHQ 4.1.1	Matematikë: 21% Lexim: 23% Shkencë: 23%	Matematikë: 30% Lexim: 30% Shkencë: 30%	Matematikë: 21% Lexim: 23% Shkencë: 30%	Matematikë: 21% Lexim: 23% Shkencë: 30%	↗
Përqindja e fëmijëve të moshës 1-17 vjeç që kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose agresion psikologjik nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar (UNICEF) – OZHQ 16.2.1	Gjithsej: 61% Vajza: 61% Djem: 61%	Gjithsej: 51% Vajza: 51% Djem: 51%	Gjithsej: 61% Shënim: Të dhënat për nivelin bazë dhe vlerat e raportuara nuk janë të krahasueshme për shkak të përdorimit të metodologjisë së ndryshme për llogaritjen e treguesit në MICS6 të vitit 2020 krahasuar me MICS5 të vitit 2014 (të dhënat e nivelit bazë)	Gjithsej: 61% Shënim: Të dhënat për nivelin bazë dhe vlerat e raportuara nuk janë të krahasueshme për shkak të përdorimit të metodologjisë së ndryshme për llogaritjen e treguesit në MICS6 të vitit 2020 krahasuar me MICS5 të vitit 2014 (të dhënat e nivelit bazë)	ND
Numri i fëmijëve në punë të fëmijëve që u identifikuan dhe mbrojtën nga mekanizmat ndërinstitucionalë dhe mbështetja e politikave (ILO) – OZHQ 8.7.1	129 (2019)	Të paktën 20% më shumë nga niveli bazë	6	Nuk ka të dhëna	ND
Migrantët e bllokuar në Kosovë kanë qasje në strehimore dhe shërbime esenciale sociale duke përfshirë kujdesin shëndetësor (IOM) – OZHQ 10.7*	Migrantët e bllokuar nuk kanë qasje në strehimore dhe shërbime esenciale sociale, përfshirë kujdesin shëndetësor	Migrantët e bllokuar kanë qasje në strehimore dhe shërbime esenciale sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor	Migrantët e bllokuar kanë qasje në strehimore dhe shërbime esenciale sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor	Migrantët e bllokuar kanë qasje në strehimore dhe shërbime esenciale sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor	↗



Rezultati 3: Deri në vitin 2025, grat dhe burrat në Kosovë, veçanërisht të rinjtë dhe grupet e cenueshme, gëzojnë qasje të rritur në punë të denjë dhe përfitojnë nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik, i cili është më rezilient ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, fatkeqësive dhe emergjencave

Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Përqindja e të rinjve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim (NEET) (UNDP/UNICEF) – OZHQ 8.6.1	Gjithsej: 30,1% Vajza: 30,2% Djem: 30% (2020)	Gjithsej: 25% Vajza: 25% Djem: 25%	Gjithsej: 33,6% Vajza: 33,2% Djem: 34%	Gjithsej: 31,7% Vajza: 32,7% Djem: 30,8%	↘
Niveli i përmirësimit të politikave, rregullave dhe rregulloreve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe të drejtat për punë të denjë. (ILO-UNOPS - IOM) - OZHQ 8.8.2	7,285 inspektime pune të kryera (2017) Inspektorët e punës nuk janë të profilizuar dhe të specializuar për SSHP Nuk ka pajtueshmëri të plotë të rekrutuesve kryesorë me standardet ndërkombëtare të rekrutimit për migrimin për motive punësimi	Rreth 15,000 inspektime pune të kryera (UNOPS) Rreth 50% e inspektorëve të punës janë të profilizuar dhe të specializuar për SSHP (30% gra) (UNOPS) Ka pajtueshmëri të plotë të rekrutuesve kryesorë me standardet ndërkombëtare të rekrutimit për migrimin për motive punësimi	Nuk ka përmirësim në ligjin për SSHP dhe ligjin për IP-në	Nuk ka përmirësim në ligjin për SSHP dhe ligjin për IP-në	ND
Numri i qytetarëve që përfitojnë nga masat për rimëkëmbje socio-ekonomike (UNDP-IOM)	0 (2021)	Numri i individëve vendoset sipas caqeve të përgjithshme të qeverisë (50% gra dhe 10% përfitues jo-shumicë 2025)	Gjithsej: 104 Gra: 45% Përfitues jo-shumicë: 100%	160 (familje) Gra: 50,91% Përfitues jo-shumicë: 100%	↗
Përqindja e grave pronare të pronave (UN Women) – OZHQ 1.4 dhe OZHQ 5.a.1 (b)	17% (2019)	22%	18%	19%	↗
Përqindja e bizneseve të udhëhequra nga gratë (UN Women)	11% (2019)	15%	11.60%	13.00%	↗
Koha mesatare e shpenzuar në punë shtëpiake dhe përkujdesje pa pagesë (UN Women) - OZHQ 5.4.1	7.2 orë për grat dhe 2.5 orë për burrat (2018)	4.5 orë për grat dhe 2 orë për burrat	7.2 orë për grat dhe 2.5 orë për burrat	Nuk ka të dhëna të disponueshme	ND
Përqindja e popullsisë totale bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta mbi tokën bujqësore, sipas seksit: dhe pjesa e grave midis pronarëve ose bartësve të të drejtave të tokës bujqësore, sipas llojit të zotërimit (FAO) - OZHQ 5.a.1 (a) 5.a.1 (b)	Gra: 4,9% Burra: 94,9% (2017)	Gra: 20% Burra: 80%	Nuk ka të dhëna të disponueshme	Nuk ka të dhëna të disponueshme	ND



Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Niveli i ndotjes së ajrit (UNDP) – OZHQ 11.6.2	Rajoni i Prishtinës gjatë periudhës tetor-dhjetor: PM10: 56 µg/m ³ ; PM2.5: 42 µg/m ³ (2018)	Rajoni i Prishtinës gjatë periudhës tetor-dhjetor: PM10: 30 µg/m ³ ; PM2.5: 20 µg/m ³	Nuk ka të dhëna të disponueshme	Nuk ka të dhëna të disponueshme	ND
Është avancuar agjenda për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (UNDP) (Niveli i emetimeve të përgjithshme të gazrave serrë (GS)) (UNDP) – OZHQ 13.2.1	10.5 Mt CO2 eq (2015)	9.5 Mt CO2 eq (2025)	Nuk ka të dhëna të disponueshme	Nuk ka të dhëna të disponueshme	ND
Përqindja mesatare e sipërfaqes së komunave që mbulohet me plane rregullatore të detajuara ose harta zonimi (UN-Habitat) – OZHQ 11.A.1	14.05% (2019)	25%	6.88%	Nuk ka të dhëna të disponueshme	↘
Performanca mesatare e komunave në treguesit e mbrojtjes së mjedisit (Zbatimi i planit lokal për veprim mjedisor; Lejet mjedisore komunale të lëshuara; dhe ndërtesat e reja që kanë aplikuar për leje mjedisore komunale) (UN-Habitat)	65.64% (2019)	75%	44.69%	Priten të dhënat	↘
Sipërfaqja pyjore si përqindje e sipërfaqes totale të tokës (FAO) – OZHQ 15.1.1	44.7% (481.000 ha)	Rritja e sipërfaqes pyjore për 3% (2023)	481.000 ha	481.000 ha	ND
- Sipërfaqja me mbulesë pyjore (% e tokës totale)					
Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (FAO) – OZHQ 15.2.1					
- Sipërfaqja (ha) nën Planet për Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve (PMP)	60% e pyjeve publike aktualisht janë të mbuluara me PMP	90% e sipërfaqes pyjore publike e mbuluar me PMP valide (2025) PMP	80%	80%	
- Shkalla e zbatimit të PMP-së	Shkalla e zbatimit të PMP-së 10%	Shkalla e zbatimit 50% (2025)			
- Pjesa e Planifikimit për Menaxhim me Shumë Qëllime të Pyjeve	Pa PMP me shumë qëllime	4 PMP të reja me shumë qëllime që mbulojnë të paktën 20,000 ha (2025)	0%	0%	
			0	0	



Rezultati 4: Deri në vitin 2025, të gjitha komunitetet në Kosovë , përfitojnë në mënyrë të barabartë nga angazhimi gjithëpërfshirës dhe kohezioni më i madh social.

Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Përqindja e qytetarëve që janë ndjerë të diskriminuar në një situatë në gjashtë muajt e fundit (UNDP) – OZHQ 10.2.1	Gjithsej: 11% (2019) Burra: 12,5% Gra: 9,5% Shqiptarë të Kosovës: 10,9% Serbë të Kosovës: 15,2% Të tjerë në Kosovë: 12,2%	Më pak se niveli bazë	Gjithsej: 10,3% Burra: 8,9% Gra: 7,5% Shqiptarë të Kosovës: 8,7% Serbë të Kosovës: 15,7% Të tjerë në Kosovë: 11,9%	Gjithsej: 4,15% Burra: 4,2% Gra: 4,2% Shqiptarë të Kosovës: 4% Serbë të Kosovës: 3,6% Të tjerë në Kosovë: 10,8%	↗
Kënaqshmëria e publikut me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (UNDP)	Gjithsej: 42,30% (2020) Burra: 43% Gra: 41,50% Shqiptarë të Kosovës: 42,60% Serbë të Kosovës: 8,6% Të tjerë në Kosovë: 51,50%	Më shumë se niveli bazë	Gjithsej: 39,5% Burra: 44,1% Gra: 44,2% Shqiptarë të Kosovës: 43,8% Serbë të Kosovës: 6,2% Të tjerë në Kosovë: 55,7%	Gjithsej: 41,9% Burra: 44% Gra: 41% Shqiptarë të Kosovës: 42% Serbë të Kosovës: 7,7% Të tjerë në Kosovë: 56%	↘
Përqindja e popullsisë që mendon se marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës “nuk janë aq të tensionuara” dhe “nuk janë aspak të tensionuara” (UNDP/IOM) – OZHQ 16.b.1	Gjithsej: 20,2% (2019) Burra: 22,5% Gra: 17,9% Shqiptarë të Kosovës: 20,9% Serbë të Kosovës: 13,1% Të tjerë në Kosovë: 14,2%	Më shumë se niveli bazë	Gjithsej: 21,9 % Burra: 25,2% Gra: 24% Shqiptarë të Kosovës: 25,1% Serbë të Kosovës: 20,9% Të tjerë në Kosovë: 36,8%	Gjithsej: 20,9% Burra: 21% Gra: 21% Shqiptarë të Kosovës: 21,3% Serbë të Kosovës: 25% Të tjerë në Kosovë: 15%	↗
Përqindja e popullsisë që “pajtohet” dhe “pajtohet plotësisht” se Kosova duhet të jetë shtet laik, me shumë religjione (UNDP)	Gjithsej: 46,6% (2019) Burra: 48,3% Gra: 44,8% Shqiptarë të Kosovës: 46,8% Serbë të Kosovës: 35,5% Të tjerë në Kosovë: 42,8%	Më shumë se niveli bazë	Gjithsej: 46,2 % Burra: 51,3% Gra: 46,1% Shqiptarë të Kosovës: 47,9% Serbë të Kosovës: 33,1% Të tjerë në Kosovë: 53,3%	Gjithsej: 47,4% Burra: 50% Gra: 46% Shqiptarë të Kosovës: 49% Serbë të Kosovës: 22,4% Të tjerë në Kosovë: 51%	↗
Përqindja e bizneseve të udhëhequra nga gratë (UN Women)	11% (2019)	15%	11.60%	13.00%	↗
Koha mesatare e shpenzuar në punë shtëpiake dhe përkujdesje të papaguar (UN Women) - OZHQ 5.4.1	7.2 orë për gratë dhe 2.5 orë për burrat (2018)	4.5 orë për gratë dhe 2 orë për burrat (2018)	7.2 orë për gratë dhe 2.5 orë për burrat	Nuk disponohen të dhëna	ND
Përqindja e totalit të popullsisë bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta në tokë bujqësore, sipas gjinisë: dhe pjesa e grave midis pronarëve ose bartësve të të drejtave në tokë bujqësore, sipas llojit të posedimit (FAO) - OZHQ 5.a.1 (a) 5.	Gra: 4,9% Burra: 94,9% (2017)	Gra: 20% Burra: 80%	Nuk disponohen të dhëna	Nuk disponohen të dhëna	ND



Rezultati 5: Deri në vitin 2025, të gjitha gratë dhe burrat në Kosovë, veçanërisht të rinjtë, grupet e cenueshme dhe personat e zhvendosur, gjithnjë e më shumë e arrijnë barazinë gjinore dhe i kërkojnë të drejtat e tyre, si dhe i përmbushin përgjegjësitë qytetare

Treguesi	Niveli bazë	Caku (2025)	Vlera aktuale (2021)	Vlera aktuale (2022)	Trendi
Përdorimi i kontraktivëve nga gratë dhe të rinjtë në moshë riprodhuese (UNFPA)	Shkalla e prevalencës së kontraktivëve modernë 13% (2014) 37,3% e grave të reja (67,6% e burrave të rinj) raportojnë përdorimin e një prezervativi gjatë marrëdhënies së fundit seksuale me një partnere/partner seksual jomartesor me të cilën/cilin nuk bashkëjeton në 12 muajt e fundit (2014)	Gjithsej: 18% (2025) Të reja: 45% Të rinj: 70% (2025)	Gjithsej: 9,4% Të reja: 37,3% Të rinj: 67,6%	Matur nga të dhënat MICS (priten në vitin 2023)	ND
Përqindja e grave të moshës 15-49 vjeç, të cilat janë aktualisht të martuara ose në bashkësi, të cilat janë pjellore dhe duan të lënë hapësirë mes lindjeve të tyre ose të kufizojnë numrin e fëmijëve që kanë, dhe të cilat aktualisht nuk përdorin kontracepsion (UNFPA) – OZHQ 3.7.1*	8.9% (2014)	7% (2025)	11.90%	Matur nga të dhënat MICS (priten në vitin 2023)	ND
Përqindja e qytetarëve të moshës 15-49 vjeç që pohojnë se dhuna në familje është e justifikuar (UNFPA)	Gra: 32,9% Burra: 14,9% (2014)	Gra: 27% Burra: 10% (2025)	Gra: 24,7% Burra: 12,2%	Matur nga të dhënat MICS (priten në vitin 2023)	ND
Numri i ankesave për dhunë në familje (UN Women) – OZHQ 5.2.1*	Gjithsej: 2,198 (2019) Gra 1,530 (70%) Burra 668 (30%) Komunitete shumicë 1,848 (84%) Komunitete jo-shumicë 350 (16%)	Ulje për 20%	Rritje për 15%	Rritje për 21% Gra 2,278 (81,5%) Burra 515 (18,5%) Komunitete shumicë 2,372 (85%) Komunitete jo-shumicë 422 (15%)	↗
Numri i kërkesave për shkelje të të drejtave të paraqitura nga gratë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit (UN Women)	550 (2019)	600	1,536	E padisponueshme	ND
Përqindja e qytetarëve që kanë kryer ndonjë punë vullnetare në 12 muajt e fundit (UNV)	15% (2017)	25% (50% Gra)	Nuk është vlerësuar në vitin 2021	Nuk është vlerësuar në vitin 2022	ND
Numri i personave të zhvendosur dhe personave të cenueshëm që fitojnë të drejta civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore (UNHCR, IOM) – OZHQ 10.3.1	Gjithsej: 600 (294 gra) persona të zhvendosur	Gjithsej: 2,500 (1,225 gra) persona të zhvendosur	Gjithsej: 752 (74 gra) persona të zhvendosur	403 (UNHCR) 1,038 migrantë (përfshirë 273 gra) (IOM)	—



